



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin Bashkia Prrenjas**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**Auditim Financiar**

**Tiranë, 2025**

## Përmbajtja

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	3
1. Përshkrim i shkurtër i Auditimit.....	3
3 OPINIONI I AUDITIMIT .....	4
<b>II. HYRJA</b> .....	6
1. Objektivat dhe qëllimi .....	6
2. Identifikimi i çështjes.....	7
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	7
4. Përgjegjësitë e audituesve.....	8
5. Kriteret e vlerësimit:.....	8
6. Standardet e auditimit.....	9
7. Metodatat e auditimit.....	9
8. Dokumentimi i auditimit .....	10
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b> .....	11
1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Prrenjas. ....	11
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.....	12
2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik. ....	12
2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	28
2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar.....	42
2.4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	69
2.5. Të Ndryshme, Të Dala Gjatë Auditimit.....	84
<b>IV. REKOMANDIME</b> .....	84

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **1. Përshkrim i shkurtër i Auditimit**

#### ***a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:***

Bashkia Prrenjas, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

**b.** Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Bashkisë Prrenjas për periudhën e aktivitetit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

#### ***c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimet e auditimit të tij:***

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga Bashkia Prrenjas. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme: Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
- Auditim mbi Burimi i krijimit i të ardhurave.
- Auditim mbi Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2024.
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

#### ***d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.***

Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar transaksionet e likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme.

#### ***e. Paraqitja e gjetjeve kryesore:*** Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

##### Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave.

Nga auditimi konstatohet se, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2023 është në vlerën 91,432,408 lekë, vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2024 është 63,907,340 pakësimet gjatë vitit 2024 janë 57,543,302 lekë dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive në fund të vitit 2024 është në vlerën 97,796,446 lekë.

##### Auditimi mbi Pasqyrat Financiare:

-Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 1,290,000 lekë, pasi nuk është kontabilizuar vlera e aksioneve të Ujësjiellës Kanalizimeve Bashkia Prrenjas e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec me Nipt. M24416601U. Sipas të dhënave të QKB-së rezulton se vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Prrenjas është 12.9 % ose 1,290,000 lekë ( $12.9 * 10,000,000 / 100 = 1,290,000$  lekë).

Nga auditimi u konstatua se llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Prrenjas, në fund të vitit 2024 ka në përbërje të saj fonde në vlerën

36,630,270 lekë, të cilat përfaqësojnë vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit. Nga Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve pasi nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 36,630,270 lekë. Kjo ka ndodhur pasi nuk është bërë shkëmbim informacioni midis drejtorive Të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve dhe Drejtorisë së Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale në lidhje me adresën e saktë të subjekteve sipas llojit të investimit të kryer. Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja “ë”; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **b. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

Drejtorja e Financës në Bashkinë Prrenjas, të marrë masat e nevojshme, që të saktësojë regjistrimet kontabël duke debituar llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredituar llogarinë 1011, “Shtesa të fondit bazë.

-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Prrenjas, të marrin masa konkrete duke përdorur të gjithë instrumentet ligjorë të parashikuar për mbledhjen me forcë të detyrimeve të papaguara me qëllim uljen e borxhit nga taksat dhe tarifave vendore.

- Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve, të marrin masat e nevojshme për saktësimin e adresave të subjekteve që u ka kaluar afati për vlerën e garancisë së kontratave, të kryhen njoftimet përkatëse në mënyrë që të bëhet i mundur zhbllokimi i fondeve, gjendje në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” dhe ne rast të mos reagimit të subjekteve të shihet mundësia që këto fonde të përdoren për interes publik.

### **3 OPINIONI I AUDITIMIT**

#### **I. Opinioni mbi Pasqyrat Financiare:**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Prrenjas për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Prrenjas janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar, me rezervë**, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

#### **Baza për opinionin e modifikuar me rezervë<sup>1</sup>:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin

<sup>1</sup> Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

“Përgjegjësitë e Audituesit”, pjesë e raportit përfundimtar të auditimit. Ne kemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 14,912 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2024, si dhe parregullsitë e mëposhtme:

- Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 190,338,038 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 237,089,210 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumës së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 267,205,176 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 38,675,760 lekë.
- Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 3,072,588 lekë e cila i përket debitorit DPSHTRR dhe nuk janë pasqyruar gjobat e IMTV në vlerën 5,020,000 lekë.
- Nga auditimi konstatohet se në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” janë përfshirë projekte me objekt; Hartim projekti KUZ Prrenjas, Hartim projekti; ujësjellësi Urakë, Kotodesh, Katjel; Hartim projekti i digës liqenet e Likopathrës dhe Hartim projekti rrethim i shkollës së mesme Rrajcë, në vlerën 9,622,240 lekë (kosto historike) të cilat nuk janë kontabilizuar drejt, pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e investimit.
- Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” konstatohet se për transferimin e aktiveve të ish UK Bashkia Prrenjas në vlerën 240,034,568 lekë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis Bashkisë Prrenjas dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Prrenjas.
- Në gjendjen e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” në vlerën 17,349,552,179 lekë (kosto historike) është përfshirë vlera 6,969,028 lekë (kosto historike) dhe në llogarinë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 703,306,598 lekë (kosto historike) është përfshirë vlera 57,966,654 lekë, të cilat janë të pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Këto vlera janë trashëguar nga bilanci i ish-komunave (në formë tabelore në programin Excel)
- Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 1,290,000 lekë, pasi nuk është kontabilizuar vlera e aksioneve të Ujësjellës Kanalizimeve Bashkia Prrenjas e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec me Nipt. M24416601U. Sipas të dhënave të QKB-së rezulton se vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Prrenjas është 12.9 % ose 1,290,000 lekë ( $12.9 * 10,000,000 / 100 = 1,290,000$  lekë).
- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 82,708,067 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 82,708,067 lekë, e cila nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.
- Llogaritja e amortizimit për aktivet jo materiale është bërë mbi vlerën e mbetur dhe jo me metodën lineare.
- Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” paraqitet në vlerën 38,675,760 lekë, ku janë përfshirë edhe fonde të ngurtësuar për objekte që kanë përfunduar në vlerën 36,630,270 lekë.

Bashkia Prrenjas nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për zhbllokimin e këtyre fondeve.

- Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 1,450,630,388 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 17,449,305,980 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 22,108,530 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 80,356,394 lekë, amortizimin shtesë në vlerën 73,025,701 lekë, sistemimet e bëra si rezultat i konstatimeve për kontabilizimet e dubluara në periudha të mëparshme në vlerën 132,618,378 lekë dhe amortizimin e pakësimit në vlerën 4,280,413 lekë për vitin ushtrimor 2024 sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 127,145,303 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është pasqyruar vlera 3,072,588 lekë e cila i përket debitorit DPSHTRR.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr.403/1 prot., datë 08.04.2025 i ndryshuar “Auditim Financiar në Bashkinë Prrenjas”, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 10.04.2025 – 13.06.2025, në subjektin Bashkia Prrenjas për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2024 – 31.12.2024, u krye “Auditim Financiar” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. S.D, Përgjegjës grupi;
2. L.Z, Auditues;
3. A.D, Auditues;
4. K.K, Auditues;
5. B.B, Auditues;
- 6.T.A, Auditues;
7. A.S, Auditues;

### **1. Objektivat dhe qëllimi**

Auditimi i Përputhshmërisë në Bashkinë Prrenjas kishte si objektiva kryesore: - Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij; - Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315); - Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Prrenjas është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia

e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

## **2. Identifikimi i çështjes**

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi baza të riskut, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Prrenjas, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Prrenjas.

## **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Kryetari i Bashkisë Prrenjas (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Prrenjas, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

#### **4. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Prrenjas në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Prrenjas është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH-së kanë aplikuar gjykimin dhe skepticismin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

#### **5. Kriteret e vlerësimit:**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Prrenjas është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Prrenjas. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar;

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 84/2022, datë 24.11.2022, “Për buxhetin e vitit 2023” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e
- Udhëzimi nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016, “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimi nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi nr. 10, datë 28.02.2020, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023”;
- Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njëjësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;
- Etj..

## **6. Standardet e auditimit**

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

## **7. Metodat e auditimit**

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korigjime të shumta të shifrave etj. Verifikimi i transaksioneve - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

Intervistimi - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

Raporte dhe informacione - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

## **8. Dokumentimi i auditimit**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimet e mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport Auditimi. Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar: ) Etika dhe pavarësia; ) Kontrolli i cilësisë; ) Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësi të tyre; ) Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me: 3 Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit 19 Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim: Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit. Plotësia:

Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar; Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme; Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël; Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura; Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion; Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës: Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë; Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet; Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar; Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara; Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese: Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit; Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë; Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese; Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Prrenjas.**

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Auditimi në subjektin “Bashkia Prrenjas”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës (*materiale por jo të përhapura*), si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve, lejeve të ndërtimit etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

## **2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit**

### **2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.**

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit “Nr. 403/1 prot., datë 08.04.2025” i ndryshuar , “Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik”:

-Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Referuar kuadrit ligjor të veprimtarisë së Bashkisë Prrenjas si më poshtë:

-Ligji nr.10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar;

-Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

-Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;

-Ligji nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;

-Ligji nr. 68/2017 “Për financat e Njërive të Vetëqeverisjes Vendore”;

-Ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”;

-VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr.746/2018;

-VKM nr. 833 datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”;

-Udhëzimi nr. 15 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

- Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektivitet të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e riskut, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Prrenjas, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

Auditim për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024

#### **I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”**

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit drejtues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat e menaxhimit dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

### **Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike.**

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Prrenjas në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se: Rregullimi i veprimtarisë në Bashkinë Prrenjas për vitin 2024 është bërë sipas përcaktimeve në “Rregulloren e brendshme” për vitin 2022, miratuar me Vendimin e kryetarit me nr. 52, datë 24.05.2022, “Për Miratimin e Rregullores Mbi Organizimin, Funkcionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Prrenjas dhe Njësive Administrative”. Kjo rregullore është e pa përditësuar dhe është jo në përputhje me strukturën organizative të miratuar për vitin 2024.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se: Nuk ka përditësim të kësaj rregulloreje për periudhën 24.05.2022-31.12.2024.

-Në rregulloren e brendshme të Bashkisë Prrenjas janë përcaktuar procedurat për sinjalizimin dhe ndëshkimin e rasteve të parregullsisë, mashtrimeve apo veprimeve korruptuese, bazuar në përcaktimet e parashikuara në legjislacionin për “*Shërbimin civil*” dhe “*Kodin e punës*”. Gjatë vitit 2024 nuk ka pasur raste të raportimit të mashtrimit, shënimeve fiktive, etj. Kërkesat apo ankesat drejtuar institucionit depozitohen zyrtarisht pranë institucionit, duke i'u adresuar titullarit, dhe strukturës e cila do të angazhohet për trajtimin e tyre, sipas “Rregullores së Brendshme të Bashkisë Prrenjas”, neni 24.

Nga auditimi konstatohet se: Në total, numri i kërkesave dhe ankesave të ardhura në Bashkinë Prrenjas për vitin 2024 është 880 (tetëqind e tetëdhjetë), të cilat kanë marrë përgjigje nga personat përgjegjës.

Njohja e stafit të Bashkisë Prrenjas me “Rregulloren e Brendshme” dhe bazën ligjore në fuqi është kryer në mënyrë shkresore dhe elektronike, sipas fushës dhe strukturave përkatëse. Drejtoritë dhe sektorët, sipas strukturës organizative, në disa raste nuk kanë kryer vlerësimin e punës për punonjësit përkatës. Vlerësimi i kryer është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari i autorizuar sipas përcaktimeve të: Ligjit nr. 152/2013 për “*Për Nënpunësin Civil*”, i ndryshuar, Ligji nr. 9367 datë 08.09.2003 “*Për rregullat e Etikës në Administratën Publike*”, Ligji nr. 9367 dat 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar; Ligji nr.119/2014 “*Për të Drejtën e Informimit*” datë 17.10.2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar; VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë*”; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se:

- Nuk ka programe të trajnimit të dedikuara për punonjësit lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatorë, integritetin dhe sjelljen etike.

- Bashkia ka përcaktuar procedura për mbrojtjen e sinjalizuesve në përputhje me ligjin nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”. Për sinjalizuesit, konstatohet: se nuk ka evidenca që të tregojnë aftësinë e njësive publike për të kryer një hetim të brendshëm të drejtë dhe të plotë. Gjatë vitit 2024, janë dhënë 5 (pesë) masa disiplinore për punonjësit.

Nga auditimi mbi veprimtarinë e Bashkisë Prrenjas dhe përputhshmërinë e hartimit të “Rregullores së Brendshme” u konstatua se:

- Për vitin 2024, rregullorja e brendshme nuk është përditësuar që ti përgjigjet strukturës së miratuar të Bashkisë Prrenjas.

**Parimi 2 - Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje**

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi rezultatet e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Kryetari i bashkisë merr opinione mbi rezultatet e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga: Njësia e Auditit të Brendshëm, Njësia e Harmonizimit në MF, Auditimi i jashtëm (KLSH). Në rregulloren e brendshme të institucionit, janë përcaktuar procedurat mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit lidhur me ushtrimin e përgjegjësi mbikëqyrëse të cilat përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA, stafit drejtues dhe punonjësve të këtij institucioni sipas strukturës organizative të miratuar për vitin 2024. Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së institucionit i cili raporton periodikisht për buxhetin vjetor të tij pranë Këshillit Bashkiak dhe në MF. Nga drejtoritë apo sektorët, në përgjithësi, hartohen e raportohen pranë titullarit në mënyrë periodike dhe vjetore raportet dhe planet vjetore të punës mbi analizën e veprimtarisë, sipas kronologjisë dhe formateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme dhe sipas fushave që ato mbulojnë.

Nga auditimi për zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 18, pika 1, për dërgimin e Deklaratës për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm pranë Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, konstatohet se: Për vitin 2024, dokumentacioni është dërguar në institucionin përkatës me shkresën nr. 424 prot., datë 17.02.2025.

### **Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë**

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organi gramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësi funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit/Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

-Për vitin 2024, numri i përgjithshëm i punonjësve të institucionit është miratuar me Vendimin e KB nr. 5, datë 27.12.2023, “Për Miratimin e kategorizimin nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar për vitin 2024”; Vendimin të KB të Bashkisë Prrrenjas nr.15, datë 27.12.2023 “Për Miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë, institucioneve në varësi dhe njësi administrative për vitin 2024” konfirmuar ligjshmëria nga Prefektura e Qarkut Elbasan, me shkresën nr. 69/1 prot., datë 12.01.2024, ku numri maksimal i punonjësve paraqitet 325 punonjës. Në numrin maksimal të punonjësve janë përfshirë edhe 4(katër) punonjës provizorë.

#### **- Struktura organizative e Bashkisë**

Administrata e Bashkisë përbëhet nga funksionarët politikë(jo nëpunës civil), nëpunësit civilë dhe punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës.

Nga auditimi konstatohet se, në rregulloren e brendshme, nuk ka përgjegjësi dhe detyra të mirë përcaktuara për të gjitha pozicionet e punës.

Nga auditimi konstatohet se:Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Prrrenjas nuk përcakton; objektivat dhe detyrat specifike për të gjithë sektorët dhe specialistët sipas “Strukturës Organizative”, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në nivel drejtorie, përgjegjësi, specialisti dhe linjat e raportimit duke respektuar hierarkinë e pozicioneve të punës.

Bashkia Prrenjas ka adresën dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur informacione të rëndësishme mbi veprimtarinë e saj si dhe të Njësive Administrative.

Nga auditimi mbi veprimtarinë e Bashkisë Prrenjas në lidhje me faqen zyrtare në internet u konstatua se: Adresa postare dhe elektronike (<https://bashkiaprrrenjas.gov.al>) e zyrave të Bashkive/njësive administrative të Bashkisë nuk aksesohet në të gjithë elementët përbërës të saj, pasi nuk janë ngarkuar dokumentet përkatës.

Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Mënyra e delegimit të detyrave është e përcaktuar në “Rregulloren e brendshme” të institucionit në nenin 15.

Delegimet, për vitin 2024, janë bërë në mbështetje të nenit 8, nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; të nenit 28, nenit 29, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Në bashkinë Prrenjas në lidhje me delegimet ka urdhra delegimi sa më poshtë:

1. Në dokumentin me nr. 426 prot., datë 01.02.2024 është urdhri “Për delegim kompetencash” Nr. 83, datë 01/02/ 2024. Delegimi i kompetencave të Kryetarit të Bashkisë, zëvendës kryetarit z. A.K, për drejtimin organizimin e punës, kontrollin dhe monitorimin e aktiviteteve të Drejtorisë së Shërbimeve Utilitare dhe Infrastrukturës Rrugore.

Në funksion të realizimit të përgjegjësive sa më sipër zëvendës kryetarit z. A.K i delegohen kompetencat si më poshtë.

Të kontrollojë dhe nënshkruajë të gjithë korrespondencën shkresore, aktet e nevojshme administrative, në funksion të realizimit të përgjegjësive të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri. Kontrollon dhe nënshkruan materialet që paraqiten në Këshillin Bashkiak, si relacione, projekt-vendime etj, që kanë lidhje me ushtrimin e përgjegjësive të përcaktuara në këtë urdhër, si dhe merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të tij.

2. Urdhër me nr. 62, datë 20.11.2024, për delegim kompetence përkohësisht, për znj. S. D. “Bashkisë Prrenjas”, të cilës i janë deleguar kompetencat e “Njësisë përgjegjëse të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesit” ku nuk është përcaktuar afati kohor.

Nga auditimi në lidhje me delegimet konstatohet se:

## **2 - Baza Ligjore e Pajlotë**

Në bazën ligjore të delegimit të kompetencave nuk cilësohet përputhshmëria me Ligjin Nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin.” të ndryshuar, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues” dhe neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”. Këto dispozita përcaktojnë se titullari mbetet përgjegjës për detyrat e deleguara dhe kërkojnë kriteret e qarta mbi atë çfarë delegohet, për sa kohë dhe me çfarë përgjegjësish anësore.

## **Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave**

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.

Marrëdhëniet e punës për nëpunësit e Bashkisë Prrenjas në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist rregullohen sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të tij, punonjësit administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Për çdo pozicion pune, në pak raste, janë hartuar dhe kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse. Nga auditimi mbi veprimtarinë e Bashkisë Prrenjas dhe përputhshmërinë e hartimit të “Rregullores së Brendshme” u konstatua se: Për disa pozicione pune, nuk janë hartuar dhe nënshkruar sipas hierarkisë “Përshkrimet e punës” të punonjësve, veprime në kundërshtim me VKM nr. 142, datë

12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.

**Të dhëna për pozicionet me status nëpunësi civil dhe me Kod pune**

Referuar të dhënave të paraqitura në “Strukturën organizative” të miratuar për vitin 2024 dhe në pasqyrën përmbledhëse mbi shpërndarjen e numrit të punonjësve (me status nëpunësi civil dhe me Kod pune), konstatohet se; numri maksimal i punonjësve të miratuar sipas VKB nr.15, datë 27.12.2023, “Për Miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë, institucioneve në varësi dhe njërive administrative për vitin 2024” paraqitet:

Numri total i punonjësve: 325, nga të cilët:

a) 89 punonjës të aparatit të Bashkisë dhe Njësitë administrative;

b) 38 punonjës Punët Publike; Policia Bashkiake 5 punonjës; Mbrojtja nga Zjarri dhe

Shpëtimin 14 punonjës; Mirëmbajtja e Rrugëve dhe Transporti

35 punonjës; Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave 14 punonjës; Arsimi Parashkollor (Edukatore+

punonjës mbështetës në Kopshte dhe Shkolla 9 vjeçare + Edukatore ndihmëse) 66 punonjës; 4

Punonjës mbështetës në Shkollën e Mesme; Çerdhja Prrenjas 14 punonjës; Arsimi, Sporti dhe

Kultura 10 punonjës; Ujitja dhe Kullimi 10 punonjës; Gjendja civile 4 punonjës; 10 punonjës me

kontratë (me afat/ sezonale); “Qendra Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuar” (Projekt) 9

punonjës; “Shtëpia e të moshuarve Prrenjas” (Projekt) 3 punonjës.

**Procedura e rekrutimit** për vendet e lira të punës për nëpunësit civil përcaktohet në: Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.; VKM nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura nga ky institucion për rekrutimin dhe largimin e punonjësve për vitin 2024 u konstatua se:

- Nga ana e Bashkisë Prrenjas nuk janë kryer procedura rekrutimesh të reja, për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil për të gjitha pozicionet vakante.

**Procedura e largimeve**

-Për vitin 2024 rezultojnë 31 (tridhjetë e një) praktika për largime të punonjësve nga puna.

Emërimet dhe largimet nga puna për vitin 2024 paraqiten në tabelën në vijim.

Tabela nr.1 Punonjës të rekrutuar dhe të larguar nga puna.

PERIUDHA	Largimet	Arsyeja	Emërimet	Procedura e ndjekur
2024	31	15 punonjës – dorëheqje nga vendi i punës 6 punonjës- pension pleqërie 2 punonjës -vdekje e punëmarrësit 7 punonjës -përfundim kontrate si punonjës zëvendësues(leje lindje) 1 punonjës -mungesa të pajustificuara në vendin e punës	35	Kod Pune

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Nga grupi i auditimit për të verifikuar plotësimin me dokumentacionin mbështetës të dosjeve të personelit u verifikuan disa dosje, ku nga verifikimi i tyre u konstatua se:

- Për largimet nga puna, jo në rast, nuk është zbatuar VKM 124, datë 17.02.2016, neni 29, ku të dokumentohej dorëzimi; i inventarit në ngarkim, i pajisjeve dhe mjeteve të punës në njësinë përgjegjëse, dokumentacionit për shkak të detyrës.

- Nga auditimi i dosjeve të punonjësve konstatohet se, në përgjithësi, jo në çdo rast disponohen vlerësimet periodike 6 mujore dhe vjetore të punonjësve në shkelle të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 62 në shkelle, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë”.

#### **Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale**

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësiave dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm. Grupi i Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, kjo strukturë përbëhet nga niveli menaxherial i njësisë dhe luan një rol kyç sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se:

- Për vitin 2024 disponohet urdhër për ngritjen/përditësimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) me pozicione dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë, në përputhje me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pika 8, germa b.

- Ka vendim të GMS-së për të krijuar Ekipin e Menaxhimit të Programeve për përgatitjen e programeve për vitet 2024-2026.

Në Bashkinë Prrrenjas disponohet dokument i PBA-së 2024-2026, në përputhje me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pika 8, germa a, pjesë të së cilës janë dhe strategjia me objektivat dhe prioritetet strategjike.

## **II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”**

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative e veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësisë dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

#### **Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva**

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët /NA/ Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Bashkia Prrrenjas ka vendosur objektiva në planet operationale, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat kombëtare e sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë. Këto objektiva bëhen të njohura, duke u paraqitur në Këshillin Bashkiak, si dhe duke organizuar dëgjesa me publikun.

Nga auditimi u konstatua se:

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut. Si pasojë Bashkia gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare apo realizimin e objektivat në nivelin e dëshiruar.

- Mungojnë plan-veprimet vjetore operationale të miratuara, për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që përmbajnë veprime, afate, dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

**Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon riskun për arritjen e objektivave.**

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen riskun në të gjithë njësinë publike.

Nga auditimi u konstatua se, në Bashkinë Prrrenjas, për vitin 2024, nuk është identifikuar dhe vlerësuar risku përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik që përfshin vlerësimin e rëndësisë potenciale dhe prioritetin e riskut të përputhshmërisë.

**Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve.**

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv. Në rregulloren e brendshme, neni 38, përcaktohet sjellja e punonjësve në lidhje me raportimin dhe monitorimin mbi ekspozimet ndaj mashtrimit dhe përballja me këto raste.

Nga auditimi i kryer konstatohet se, Bashkia nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj riskut për mashtrime për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësisë mbi përfitimet e këtij procesi.

**Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme.**

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë riskun dhe qasjet për të minimizuar atë në kohë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar. Bashkia Prrrenjas ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualët e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

**Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.**

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikave, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. Menaxhimi nuk duhet të fillojë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me riskun që duhet të minimizohen.

Nga auditimi i kryer , konstatohet; mungesa e hartave apo manualeve të proceseve të punës që sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësisë.

Vlen të theksojmë se, përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një imtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

Listë prezencat plotësohen nga përgjegjësi i sektorit përkatës dhe listë pagesa përpilohet nga specialisti i pagave, të dhënat hidhen çdo muaj në librin e pagave.

Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, bashkia ka hartuar procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj.. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim etj.)

Nga auditimi konstatohet se:

- Për vitin 2024, Bashkia Prrenjas nuk ka rregulla të brendshme të shkruara për të ruajtur aktivet e rëndësishme dhe aktivet afatgjata nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

#### **Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë**

Teknologjia është bërë një element kyç operacioni i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

Bashkia Prrenjas nuk ka përfshirë në rregulloren e brendshme veprimtarinë e specialistit të Teknologjisë së Informacionit. Në Bashkinë Prrenjas nuk ka sistem të ruajtjes së të dhënave. Programi i përdorur nga sektori i financës është program në Excel i cili rrit riskun e pasaktësive financiare dhe kufizon integrimin e veprimeve me një program financiar më të sigurt

Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelin tjetër të caktuar, përgjegjësi këto të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë.

#### **Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave**

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

#### **- Gjurma e auditimit**

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, Bashkia nuk ka hartuar, miratuar, gjurmën e unifikuar të auditimit duke cenuar ndjekjen e ecurisë së një procesi apo procedure që lidhet me veprimtarinë kryesore të njësisë dhe duke bërë të paqartë dhe jo të plotë për të tretët, mjedisin e kontrollit dhe vendimmarrjen lidhur me to.

#### **IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”**

Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për

sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përbushjes së objektivave si në nivel aktiviteti ashtu edhe objektivave të përgjithshme të mbarë njësisë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin. Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Menaxhimit duhet t'i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet. Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Prrenjas dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike:

**Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.**

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim të auditimit, konstatohet se bashkia nuk i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.

Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.

**Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.**

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Sa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se nuk janë hartuar procedura të shkruara për të siguruar që menaxherët dhe personeli i bashkisë të informohen mbi të gjitha vendimet, projektet, procesverbalet e mbledhjeve dhe nismat e tjera të bashkisë.

**15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm.**

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore dhe evidentohet që punonjësit në përgjithësi përdorin adresat zyrtare të e-mailit. Nga Bashkia Prrenjas kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat nuk janë të dokumentuara në proces-verbale. Nga auditimi u konstatua se:  
-Bashkia nuk përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike.

**V. Komponenti: “Monitorimi”**

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës. Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i

sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.

**Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm**

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

Në Bashkinë Prrenjas, Njësia e Auditimit të Brendshëm është krijuar, por ka mangësi në vlerësimet mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e Brendshëm. Raportimet periodike që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion përmbajnë informacion lidhur me planifikimin dhe realizimin mbi planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e Bashkisë. Monitorimi i progresit lidhur me arritjen e objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore konsiston në monitorimin e zbatimit të buxhetit. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes dhe zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm mbi arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit dhe përputhshmërinë me kuadrin rregullator në fuqi, bazuar në parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe efektivitetit.

Nga auditimi u konstatua se, në Bashkinë Prrenjas nuk ka rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

**Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë**

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi. Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

**Konkluzion:** Grupi i auditimit bazuar në informacionin e grumbulluar nga pyetësorët mbi vetëvlerësimin dhe rezultatet e testeve të kryera konstaton se komponentët e MFK-së nuk kanë funksionuar plotësisht dhe me efektivitet, në të gjithë strukturat e njësisë pavarësisht përpjekjeve të këtij institucioni për të shkuar drejt konsolidimit, konkretisht: Nga auditimi mbi vlerësimin e nivelit të implementimit të 17 parimeve përkatëse sipas komponentëve të MFK u konstatua se: Veprimtaria e Bashkisë Prrenjas paraqitet përgjithësisht në përputhshmëri me këto parime por mangësi të konstatuara si më poshtë, trajtuar për çdo parim:

- Në “Rregulloren e Brendshme” nuk janë të përcaktuara të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë mbi organizimin e veprimtarisë së institucionit sipas strukturës organizative të miratuar. Për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës bazuar në “Kodin punës” nuk janë të përcaktuara: mënyra apo kriteret e rekrutimit/largimit për çdo pozicion pune.

- Për largimet nga puna nuk është zbatuar VKM 124, datë 17.02.2016, neni 29, ku me P.V të dorëzohen inventari në ngarkim i pajisjeve në njësinë përgjegjëse, dokumentacioni për shkak të detyrës.

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut. Si pasojë bashkia gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, nuk mund të përcaktojë nivelin e performancës financiare apo realizimin e objektivat në nivelin e dëshiruar.

- Sektori i financës në Drejtoria e Financës, e planifikimit të Buxhetit dhe Integritetit Evropian në Bashkinë Prrenjas, nuk ka një program financiar, por operon me programin Excel.

- Sistemi i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

-Nga auditimi i kryer konstatohet se; bashkia nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj riskut për mashtrime për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar. Bashkia Prrrenjas ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualët e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me: Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016; ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, germa “b”; Ligjin nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, neni 13; VKM nr. 117/2014, i ndryshuar me VKM nr. 833, datë 28.10.2020, Kreu nr. 1, pika nr. 1; VKM nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, pika 2.3.

*Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar Bashkia Prrrenjas, me shkresën nr. 794/33, datë 06.10.2025 (protokolluar në KLSH me nr. 403/6 prot., datë 08.10.2025) S.Dkanë bërë komente dhe shpjegime, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:*

**Pretendimi i subjektit:** Pretendimet kanë të njëtin karakter me ato të paraqitura për Aktin e Konstatimit, pa paraqitur asnjë element, dokument apo material tjetër të panjohur nga Grupi i Auditimit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në përgjigje të pretendimeve tuaja sqarojmë se, pretendimet nuk merren në konsideratë.

## **“Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik”:**

**1.2.** Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

**1.3.** Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm, të auditimit nr.403/1 Prot, datë 10.04.2024” i ndryshuar Mbi auditimin e Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Prrrenjas, për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësisë AB të Bashkisë Prrrenjas;
2. Planet Strategjik dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Planifikimi vjetor për vitin 2024 dhe pasqyrat shoqëruese;
4. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2024;
5. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
6. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
7. Dosjet koherente të subjekteve të audituara;
8. Projekt raportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësisë publike;
9. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre;

### **1.2. Organizimi dhe funksionimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm**

Auditimi i Brendshëm është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një

veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar efektin e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.

Në zbatim të Ligjit Nr.114 datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se:

“Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në gerrat a-ç të kësaj pike” është ngritur dhe funksionon Njësia e Auditit të Brendshëm (NjAB) në varësi funksionale nga Titullari i Bashkisë Prrenjas, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.

NjAB e Bashkisë Prrenjas, organizohet në nivel “Sektori”.

Përgjatë vitit 2024, NjAB Bashkia Prrenjas, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të:

**Rregullores së Brendshme** “Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë së Prrenjas”, neni 6.

Vendimit të KB nr. 5, datë 27.12.2023, “Për Miratimin e kategorizimin nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar për vitin 2024”; Vendimin të KB të Bashkisë Prrenjas nr.15, datë 27.12.2023 “Për Miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë, institucioneve në varësi dhe njërive administrative për vitin 2024”, konfirmuar ligjshmëria nga Prefektura e Qarkut Elbasan, me shkresën nr. 48/1 prot., datë 27.03.2024.

Vendimit të Kryetarit të Bashkisë me nr. 09, datë 31.01.2024 “Për Miratimin e Strukturës së Administratës së Bashkisë Prrenjas dhe institucioneve nën varësisbazuar në numrin maksimal dhe nivelin e pagave të miratuara nga Këshilli Bashkiak për vitin 2024” të ndryshuar, duke pasur në strukturën e saj 1 (një) Përgjegjës Sektori z. Bashkim Kariqi dhe 2 (dy) specialistë auditimi, zj. Anjeza Bozha dhe z Denis Hoxholli.

Stafi auditues u intervistua lidhur me njohuritë mbi rolin, përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë e tyre për shërbimin që ofrojnë, ku u evidentua se kanë eksperiencë profesionale e në fushën e auditimit (1-10) vite dhe rezultoi se 1 (një) specialist është i pa certifikuar.

Nga auditimi për organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm u konstatua se:

- Rregullorja e brendshme e Bashkisë Prrenjas, nuk përcakton mënyrën e organizimit (në nivel drejtorie apo sektori), si dhe pjesëmarrjen e drejtuesit të NJAB në takimet dhe mbledhjet e kryetarit të Bashkisë.

NJAB ka si detyrë programimin dhe realizimin e auditimeve sipas fushave të veprimtarisë që ky institucion kryen me fokus ato fusha/veprimtari/njësi varësie të cilat paraqesin risk të shtuar. Ky plan miratohet nga Kryetari i Bashkisë, dhe ka si objektiv evidentimin e shkallës së zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik. Për vitin 2024, struktura, përbërja e NjAB-së, arsimit, vjetërsia në punë dhe certifikimi pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 1: Struktura e Auditit të Brendshëm me të dhënat sipas tabelle

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime te vijueshme
1	B.K	Përgjegjës	Nr. 554 date 20.11.2018	I Lartë Ekonomist	34	7	Viti 2021	Po
2	A.B	Audituese	Nr. 472 datë 09.10.2018	I Lartë Ekonomist	10	10	Viti 2013	Po
3	D.H	Specialist		I Lartë Ekonomist			10 muaj	Po

**Burimi:** Bashkia Prrenjas Njësia e Auditit të Brendshëm.

Për sa më sipër, nga auditimi i dokumentacionit konstatojmë se:

- NJAB në Bashkinë Prrrenjas nuk ka filluar procesin e certifikimit për 1 (një) auditues, i cili është brenda afatit të përcaktuar në Ligjit Nr.114 datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, që përcakton se:

ç) nëpunësi civil ose punonjësi që punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe që nuk zotëron certifikatën si “Auditues i brendshëm”, gjatë 3 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e drejtuesit të njësisë së Auditimit të Brendshëm ose të një audituesi të brendshëm të certifikuar dhe me eksperiencë. **Brenda kësaj periudhe, ky punonjës i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.**

#### **Trajnimet e NJAB dhe certifikimet**

Referuar Ligjit Nr.114 datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 20, i është kushtuar rëndësi trajnimeve të audituesve për të zgjeruar njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përgjegjësia për trajnimin nuk është vetëm e njësisë së auditimit të brendshëm ose strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit, por çdo auditues duhet të përditësojë individualisht njohuritë dhe aftësitë e veta mbi zhvillimet e fundit, përmirësimet, standardet e auditimit dhe këshillat praktike mbi teknikat dhe praktikat e reja të auditimit. Sa shihet në tabelën më sipër, janë kryer trajnimet e audituesve të NJAB-së të Bashkisë Prrrenjas për vitin 2024.

Kodi i Etikes; përmban parimet që rregullojnë sjelljen e audituesve të brendshëm në njësinë publike, në kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm. Në Bashkinë Prrrenjas, ky kod, është përgatitur nga Njësia e AB dhe është miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 318 datë 26.01.2024.

#### **Komiteti i Auditimit të Brendshëm:**

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësiave të saj, nuk është krijuar nga Bashkia Prrrenjas.

Referuar të Ligjit Nr.114 datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12/b, përcakton se: Titullarët e njësisë publike janë përgjegjës për:

b) krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike përkatëse sipas kriterëve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “b” të nenit 23 të këtij ligji.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me Ligjin Nr.114 datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12/b.

Konstatim: Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12/b, të Ligjit Nr.114 datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.

#### **Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik:**

Karta e Auditimit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” në Bashkinë Prrrenjas e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr. 319.prot., datë 26.01.2024 dhe rezulton se është në përputhje me formatin e paraqitur në

Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”.

Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve:

Plani strategjik është një dokument që përgatitet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publik edhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3 vjeçare. Plani vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i Auditimit të Brendshëm.

Në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, kapitulli III, miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE Nr.100, datë 25.10.2016, përcaktohet se:

“Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën 10 Tetor të çdo viti. Planet pas dhënies së mendimit të KAB-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data 20 Tetor e çdo viti, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar plani strategjik 2024-2026. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se:

- Plani strategjik për vitet 2024-2026 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2024 janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 2552/1.prot., datë 03.10.2023, në përputhje me Ligjin Nr.114 datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 14/ç.

- Raportimi i veprimtarisë vjetore për vitin 2024, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, është bërë nga NJAB e Bashkisë Prenjas me shkresën me nr. 153/1prot., datë 03.02.2025.

Krahasuar me planin vjetor, për angazhimet e planifikuara e të kryera nga NJAB për vitin 2024, konstatohet se; për vitin 2024, janë planifikuar për t’u kryer 8 auditime (7 auditime përputhshmërie, 1 auditimi financiar dhe 0 auditime të kombinuara), nga të cilat janë realizuar gjithsej 8 (tetë) auditime, më konkretisht trajtuar në pasqyrën më poshtë:

Tabela e realizimit të auditimeve

Nr.	Planifikuar	Nr. Auditime	Subjekte të audituara nga NJAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduar
				Përputhsh	Perform	Financ	IT	Kombin	
1	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit (Detyrimet e prapambetura)	1	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit (Detyrimet e prapambetura)	1		1			Po
2	Spektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	1	Spektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	1					Po
3	Drejtoria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	1	Drejtoria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	1					Po
4	Ndjekja e rekomandimeve të dhëna nga AB	1	Ndjekja e rekomandimeve të dhëna nga AB	1					Po
5	Njesite administrative	1	Njesite administrative	1					Po
6	Drejtoria e Shërbimeve Utilitare dhe Infrastrukturës Rrugore	1	Drejtoria e Shërbimeve Utilitare dhe Infrastrukturës Rrugore	1					Po
7	Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Aplikimit të Projekteve	1	Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Aplikimit të Projekteve	1					Po
8	Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore	1	Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore	1					Po
	<b>TOTALI</b>	<b>8</b>	<b>TOTALI</b>	<b>8</b>		<b>1</b>			

- Në lidhje me vlerësimin e nivelit të riskut, NJAB ka përfshirë në planifikimin vjetor dhe strategjik auditimin e veprimtarisë të sektorëve me risk të lartë.

- Në lidhje me planifikimin e nevojave për trajnim të personelit të sektorit të AB për vitin 2024 rezulton se: Për vitin 2024 nga NJAB Prrrenjas në Planin Strategjik dhe atë Vjetor janë planifikuar nevojat për trajnimin e stafit dhe janë marrë masa për planifikimin dhe kryerjen trajnimeve dhe angazhimeve pa cenuar punën audituese dhe zhvillimin profesional të stafit.

- Në lidhje me planifikimin e buxhetit dhe shpërndarjen e burimeve të Sektorit të AB për vitin 2024 rezulton se: Për vitin 2024 nga NJAB Prrrenjas në Planin Strategjik dhe atë Vjetor janë planifikuar nevojat për mbulimin e kostove të auditimit.

Struktura e Projekt Raporteve dhe e Raporteve Përfundimtare të Auditimit për vitin 2024, përgjithësisht është hartuar dhe plotësuar sipas standardit të vendosur në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, pika 4.1.12, hapi 11. Për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi “*Dosjet koherente*” të NJAB në përgjithësi janë mbajtur të plotësuara në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, në të është përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme.

### **1.3. Vlerësimi mbi veprimtarinë e “Njësisë së Auditit të Brendshëm”.**

*Nga auditimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm për vitin 2024 dhe vlerësimin e procesit për zbatimin e procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm u konstatua se:*

NJAB për vitin 2024 ka realizuar 8 (tetë) auditime nga këto: Auditim Përputhshmërie gjithsej 7 (shtatë); Auditim Financiar gjithsej 0 (zero); Auditim i Kombinuar gjithsej 1 (një); Auditim me kërkesë të Titullarit gjithsej 0 (zero).

Të detajuara auditimet e kryera nga NjAB Bashkia Prrrenjas janë paraqitur në tabelën nr.1.

Nga auditimi i dosjeve të auditimeve u konstatua se:

- Në dosjet e auditimit ka të meta dhe mangësi si; mungon dokumenti i përlogaritjes së nivelit të përgjithshëm të riskut, mungon plani i veprimit i sugjeruar.

Pasqyra e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e realizuara nga NJAB për vitin 2024, Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.

Nga grupi i auditimit për të vlerësuar procesin mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e realizuara nga NjAB për vitin 2024 u morën në shqyrtim të dhëna mbi statusin dhe numrin e rekomandimeve më datë 31.12.2023 dhe ato të vitit ushtrimor. Nga auditimi i dokumentacionit mbi sa më sipër u konstatua se: Në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016. Për vitin 2024, janë dhënë **49** rekomandime gjithsej, të cilat janë pranuar nga subjektet objekt auditimi. Nga rekomandimet e pranuar janë zbatuar 22 rekomandime dhe në proces zbatimi **21** prej tyre dhe të pazbatuar janë 6 rekomandime.

*Nga auditimi i kryer në lidhje me rekomandimet e dhëna dhe statusin e tyre, situata paraqitet në tabelë si vijon:*

Tabela Nr.3: Të dhëna mbi rekomandimet dhe statusin e tyre

Nr.	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT			
		Rekomandime te shprehura ne numër			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	Viti 2024	49	22	21	6

Burimi: NjAB Prrrenjas

- Nga auditimi i rekomandimeve të dhëna dhe zbatimi i tyre konstatojmë se:

Rekomandimet e adresuara janë pranuar 100% nga subjektet e audituara, por për nivelin e zbatimit të tyre, në përgjithësi, nuk trajtohet i detajuar progresi i rekomandimeve (masat e ndërmarra nga subjekti i audituar), me shpjegime që duhet të mbështesin statusin e çdo rekomandimi.

Kjo procedurë nuk është kryer as si detyrim i përcaktuar në Udhëzimin Nr.42, datë 27.10.2020 “*Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik*”.

Problematika nuk është trajtuar në asnjë nga format e përcaktuara në manualin e auditit të brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.13.3, ku përcaktohet se: Një njësi e mirë menaxhuar vendos procedura për t’u siguruar se çdo rekomandim i bërë nga njësi e AB, zbatohet ashtu siç duhet.

#### **Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm**

Për të analizuar mjedisin e kontrollit, në manual jepet formati standard 1 “Pyetësor vlerësimi për mjedisin e kontrollit të brendshëm” në fund të kapitullit III i cili duhet të plotësohet një herë në vit dhe të bëhet si pjesë e procesit të planifikimit fillestar. Pyetësi i vlerësimit të Mjedisit të Kontrollit ka për qëllim të ndihmojë njësinë e auditimit të brendshëm të kuptojë se sa mirë menaxhohet njësi dhe se cilat janë fushat/sistemet më me risk.

Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm është bërë vlerësimi i kontrollit të brendshëm si një nga detyrat themelore të auditimit të brendshëm. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm është bërë nga përgjegjësi dhe dy audituesit e NJAB duke qenë se nuk ka një komitet auditimi për të pasur një vlerësim më të saktë e profesional.

Konstatim: NJAB në Bashkinë Prrenjas nuk ka kryer trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

#### **Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm**

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm, si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Programi i sigurimit të cilësisë, vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Prrenjas nuk ka hartuar “*Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të njësisë së auditimit të brendshëm*” në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VII, i cili, referuar Standardit 1300 citon se:

Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të zhvillojë dhe të mirëmbajë programin e siguri dhënies dhe përmirësimit të cilësisë, i cili mbulon të gjitha aspektet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Programi për vlerësimin e cilësisë përbëhet nga vlerësimet e brendshme dhe të jashtme, që përfshijnë:

- vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga vetë njësi e auditimit të brendshëm bazuar në politikat dhe praktikën e saj;
- vlerësimin e jashtëm të cilësisë që kryhet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik, për zbatimin e metodologjisë dhe performancës së njësisë të auditimit të brendshëm; dhe
- vlerësimin e pavarur të jashtëm të cilësisë që kryhet nga një person i jashtëm, auditues në një njësi të pavarur të sistemit të përgjithshëm të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Konstatim: Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Prrenjas nuk ka hartuar “Programin e veçantë për sigurimin e brendshëm të cilësisë të njësisë së auditimit të brendshëm dhe nuk ka përcaktuar indikatorët e matjes dhe vlerësimin të performancës së veprimtarisë audituese” në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VII. Njëkohësisht nuk janë dhënë rekomandime për përmirësimin e punës audituese aty ku janë vrejtur mangësi e difekte në zbatimin e standarteve të auditimit.

*-Për veprimet e mësipërme, mban përgjegjësi, B.K, Përgjegjës i sektorit të auditit të Brendshëm.*

## **2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

-Programimi i PBA-së dhe programimi i buxhetit vjetor;

- Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

- Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave;

- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të garantëve si FZHR, Ministrisë e linjës etj.);

- Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre; Mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Prrenjas në bazë të Programit të Auditimit nr.403/1 prot., datë 08.04.2025, i ndryshuar, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024”.

Në zbatim të nënpikave 2.1-2.5, të Programit të Auditimit nr. 403/1 prot., datë 15.05.2025, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni sa më poshtë:

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA 2024-2026, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;
2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
3. Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;
4. Akt-Rakordomi i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit;
5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve;
6. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
7. Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët...

### **2.1 Programimi i PBA 2024-2026 dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2024.**

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2024-2026 rezultoi se:

Programi Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe buxheti i vitit 2024, si dhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara janë miratuar në Këshillin Bashkiak, konkretisht :

-PBA 2024-2026 bashkë me buxhetin e vitit 2024, janë miratuar me VKB nr.6, datë 27.12.2023. Buxheti vjetor është miratuar në Këshillin Bashkiak si dhe është konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Elbasan me shkresën nr.69/1 prot., datë 12.01.2024, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33/1. Për realizimin e

fazave të përgatitjes me shkresën nr. 428 prot., datë 08.02.2023, nga Kryetari i Bashkisë Prrenjas është krijuar ekipi i menaxhimit të programeve brenda afatit të përcaktuar, për përgatitjen e PBA 2024-2026.

-Me shkresën nr. 2408 prot., datë 08.09.2023, titullari i njësisë ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Programin për Buxhetin Afatmesëm (PBA 2024-2026) jashtë afatit të përcaktuar në UMF nr. 6, datë 28.02.2023, “Për përgatitjen e PBA-së Vendor 2024-2026”, Kreu I, pika 9 (brenda datës 01.06.2023).

Fondet e trashëguara të miratuara nga Këshilli bashkiak dhe të konfirmuara nga Prefektura e Qarkut Elbasan, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

*Tabela nr. 2.1: planifikimi i buxhetit për vitin 2024*

*në 000/lekë*

Nr.	Përshkrimi	Plani i vitit 2024	
		Të ardhura	Shpenzime
1	Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	66,269	
2	Transferata e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	71,635	
3	Trashëguar nga transferata specifike	15,802	
4	Të trashëguara nga FZHR	0	
5	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	135,700	
6	Granti	856,710	
7	Transferata specifike	137,998	
8	Paga (600) + sigurime shoqërore (601)		255,271
9	Shpenzime operative (602)		99,182
10	Investime (230+231) nga të ardhurat dhe tr.e pakush		113,893
11	Fondet emergjencë dhe fondet rezervë		5,504
12	Investime (230+231) nga buxheti i shtetit		87,195
13	Shpenzime (603+604+606)		472,343
<b>Totali i buxhetit</b>		<b>1,284,115</b>	<b>1,033,388</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

**Krahasimi i planeve buxhetore me PBA respektive:**

**PBA 2024-2026 me planin buxhetor 2024, paraqitet në tabelën e mëposhtme:**

*Tabela nr. 2.2: PBA 2024-2026 me planin buxhetor 2024;*

*në 000/lekë*

Nr.	Përshkrimi	Plan përfundimtar 2024	Sipas PBA 2024-2026	Diferenca
1	Shpenzimet për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	289,606	239,905	49,701
2	Shpenzimet (602, 604, 609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	176,139	138,100	38,039
3	Investime – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	197,575	112,739	84,836
4	Investime nga FZSH			0
<b>Total i planit fillestar</b>		<b>663,320</b>	<b>490,744</b>	<b>172,576</b>
<b>Shtesat dhe ndryshimet gjatë vitit</b>		<b>18,985</b>	<b>15,357</b>	<b>3,628</b>
5	Shpenzime për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	15,357	15,357	0
6	Shpenzime (602, 604, 606,609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	441		441
7	Investime nga Bashkia – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	3,187		3,187
8	Investime nga FZSH			0
9	Pagesa 5 % garanci			0
<b>Totali shtesa + ndryshime</b>		<b>682,305</b>	<b>506,101</b>	<b>176,204</b>
<b>Plani përfundimtar</b>				
	Shpenzime për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	304,963	255,262	49,701
	Shpenzime (602, 604,606, 609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	176,580	138,100	38,480
	Investime nga Bashkia – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	200,762	112,739	88,023
	Investime nga FZSH			
	Pagesa 5 % garanci			
<b>Shuma e planit vjetor</b>		<b>682,305</b>	<b>506,101</b>	<b>176,204</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

## **2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura:**

-Për vitin 2024, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 06, datë 27.12.2023. Konstatohen se gjithsej fonde për 2023 janë miratuar në buxhetin fillestar 663,320 mijë lekë, gjatë vitit fondet e planifikuara u shtuan me 43,169 mijë lekë dhe u pakësuan me 24,184 mijë lekë.

Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 2.3: paraqitja e ndryshimeve të buxheteve gjatë vitit 2024

në 000/lekë

Periudha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr. datë	Vlera	Nr. Datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli			
					Pakësim. Art.	Shuma	Shtesa. Art.	Shuma
Viti 2024	VKB nr.06, datë 27.12.2023 konf.69/1 dt 12.01.2024	663,320	VKB Nr.34 date 28.02.2024/konf.315/1 dt 11.03.2024	6,878	231	3,250	602	441
			VKB Nr.50 date 27.03.2024/konf.420/1 dt 02.04.2024	6,600	231	6,600	231	6,600
			VKB Nr.74 date 31.07.2024/konf.854/1 dt 12.08.2024	14,334	602	10,383	600/601	1,320
			VKB Nr.79 date 31.07.2024/konf.859/1 dt 06.08.2024	6,959	231	3,951	231	13,014
			VKB Nr.89 date 24.09.2024/konf.1082/1 dt 10.10.2024	8,398			600/601	8,398
Pikësimet		-24,184						
Shtesat		43,169						
<b>Totali Viti 2024</b>		<b>682,305</b>		<b>43,169</b>		<b>24,184</b>		<b>43,169</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrrenjas.

Nga sa më sipër konstatohet se, për vitin 2024 kanë ndodhur 5 ndryshime me VKB Prrrenjas me një total prej 43,169 mijë lekë. Këto ndryshime sikurse shihet nga tabela janë rialokime shpenzimesh, ndërmjet programeve, si dhe për efekt të fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit për rritjen e nivelit të pagave.

### 2.3 Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv 2024, të miratuar me VKB ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me Degën e Thesarit u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit 2024, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 2.4: Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit 2024;

000/Lekë

Nr.	Përshkrimi	Viti 2024		
		Plan	Fakt	%
1	600 – Paga	267,020	218,688	82%
2	601 – Sigurime shoqërore	44,928	36,584	81%
3	602 – Shpenzime operative	152,521	99,183	65%
4	Totali shpenzime të tjera – (606, 604, 609)	8,028	5,505	69%
5	Ndihma ekonomike	488,565	469,209	96%
6	Investimet (230 + 231)	310,097	193,998	63%
7	Shpërblime lindje – 606	3,820	3,135	82%
8	466 – Garancitë	9,137	7,090	78%
	<b>Totali</b>	<b>1,284,116</b>	<b>1,033,392</b>	<b>80%</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrrenjas.

Referuar të dhënave të pasqyrave të mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit për aparatet e Bashkisë paraqitet:

Për vitin 2024 janë miratuar në Buxhetin fillestar 663,320 mijë lekë ku fondet e planifikuara për këtë vit u shtuan me shtuan me 43,169 mijë lekë dhe u pakësuan me 24,184 mijë lekë. Buxheti total për vitin për vitin 2024 është 1,284,116 mijë lekë. Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, nga të gjithë burimet e financimit janë 1,033,392 mijë lekë me një realizim 80%. Në këtë masë realizimi kanë ndikuar:

-Shpenzimet operative llogaria 602 janë realizuar në masën 65 % i cili tregon për planifikim me rezervë të tij;

-Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është realizuar në masën 63%. Niveli i ulët vjen nga realizimi me vonesë i procedurave të prokurimit dhe si rrjedhojë dhe lidhjes me vonesë e kontratave për to, duke mos i financuar brenda vitit buxhetor;

***Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe numrit të punonjësve për Bashkinë Prrenjas jepet nga pasqyrat në vijim:***

Miratimi i Strukturave për vitin 2024 janë miratuar me VKB nr. 15, datë 27.12.2024, “Për miratimin e strukturës organizative” dhe konfirmimi i Prefektit me nr. 78/1, datë.10.01.2024, ku janë miratuar struktura, organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së Bashkisë dhe shërbimeve mbështetëse të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore.

Pasqyra e pagave për vitin 2024 Bashkia Prrenjas:

	Emërtimi	Plan	Fakt
Kap.1 (Granti)	600	227,919,734	211,066,667
	601	38,397,888	35,323,565
Kap. 5 (Të ardhurat)	600	39,100,000	7,621,568
	601	6,529,700	1,260,098

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

**Ndarja e strukturës:**

*Tabela nr. 2.5 struktura e vitit 2024 në Bashkinë Prrenjas;*

Emërtimi	Viti 2024	
	Plan	Fakt
Administrata(Aparati+Njësi adm,mbrojtja civile,tatim taksa,Qendër kulturore,IVMT.sektori arsimi,kontrolli i ushqimit,sherbime mbeshtetëse,QKAK)	106	102
Punonjës të Policisë Bashkiake	6	6
Ujitja dhe Kullimi	7	7
Punonjës të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin	14	14
Rrugët Rurale +Mirëmbajtja e makinerive	34	34
Shërbimet publike	44	44
Punonjës të Pyjeve dhe Kullotave	13	13
Gjendja civile	4	4
Arsimi bazë	67	67
Arsimi i mesëm	4	4
Çerdhja e femijeve	14	14
Qendra e te moshuarve	2	2
Punonjës me kontratë sezonale	10	10
<b>Shuma</b>	<b>325</b>	<b>321</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Nga verifikimi për raportin e punonjësve me status dhe me kontratë pune rezulton se:

**Për vitin 2024:**

Nga të punësuarit 14 janë me statusin e nëpunësit civil, marrëdhëniet e punës e të cilëve rregullohen me ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, ndërsa 41 punonjës janë

me kontratë pune marrëdhëniet e punës e të cilëve rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Sipas strukturës së miratuar me VKB:

- a. Janë gjithsej **59** pozicione pune të vlerësuara me status të Nëpunësit Civil, nga të cilat:
  - 1 pozicion i kategorisë së lartë;
  - 5 pozicione të kategorisë së mesme drejtues;
  - 11 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese;
  - 42 pozicione të kategorive ekzistuese;
- b. *Nga këto pozicione janë të lira (të paplotësuara);*
  - 1 pozicion të kategorisë së lartë drejtuese;
  - 1 pozicion të kategorisë së ulët drejtuese
  - 3 pozicione të kategorive ekzistuese;

### ***Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Prrenjas***

Nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se Bashkia Prrenjas ka marrë subvencion për bonus qiraje për periudhën objekt-auditimi. Për vitin 2024, është subvencionuar vlera prej 4,849,654 lekë, vlerë e cila i përket subvencionit për bonus qiraje, fond nga MF, Drejtoria e Strehimit ku janë trajtuar 47 familje.

### ***Të ardhurat e veta.***

Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2024 është realizuar në vlerën 96,971 mijë lekë, ose 9.3% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2024, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për investime dhe shpenzime operative.

### ***Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak.***

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në 25 Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 443 , të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Për vitin 2024, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, konkretisht:  
-Janë dërguar raportet 4-mujore, me shkresën nr.1562 prot., datë 29.05.2024 dhe VKB nr. 63 datë 28.05.2024.

-Janë dërguar raportet 8-mujore, me shkresën nr.1562 prot., datë 25.09.2024 me VKB nr. 88 prot., datë 24.09.2024 konfirmuar me shkresën nr. 10811/1 prot., datë 04.10.2024.

-Raporti vjetor me shkresën nr. 525 prot. datë 03.03.2025 miratuar me VKB, nr.12 datë 27.02.2025 konfirmuar me shkresën nr. 304/1 prot., datë 06.03.2025.

### ***2.4 Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimeve gjyqësore dhe detyrimet kontraktore.***

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Prrenjas, rezulton se është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe në fund të vitit 2024 janë raportuar në Këshillin Bashkiak dhe MFE. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2024:

*Shuma e detyrimeve të prapambetura në fund të periudhës 31.12.2024:*

Detyrime	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur në 31.12.2023	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2024-31.12.2024	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2024	Mbetja e Detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2024
Investime					
Investime nga FZSHH	0	0	0		
Mallra dhe shërbime	1,320,672	0	1,320,672	1,320,672	0
Vendime gjyqësore			0		
Të tjera					

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrrenjas.

Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që Bashkia Prrrenjas ka ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2024, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/vendim gjykatë) që krijon detyrimin përkatës.

-Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2024, përcjellë në MF me shkresën nr. 525 prot., datë 27.02.2025, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Prrrenjas ndaj palëve të treta raportuar në MF është në vlerën 0 lekë.

Stoku i detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta paraqitet më pak se 15% të shpenzimeve vjetore të miratuara, ç'ka do të thotë se Bashkia Prrrenjas në fund të vitit 2024 rezulton në një situatë normale.

***Detyrimet nga vendimet gjyqësore.***

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2024, Bashkia Prrrenjas rezulton se nuk ka detyrime nga Vendimet Gjyqësore.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2024 janë likuiduar 3,394.973 lekë.

Gjatë periudhës ushtrimore 2024, ka patur shtesa detyrimesh nga vendimet gjyqësore nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtja Sociale në vlerën 15,482,849 lekë. Janë likuiduar gjatë kësaj periudhe vlera prej 15,482,849 lekë.

***2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara nëpërmjet FZSHH/Ministrisë së linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.***

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për periudhën 01.01.2024- 31.12.2024, në lidhje me investimet publike, u konstatua se Bashkia Prrrenjas ka marrë 5 financime projektsh nga FSHZH/FZHR.

Në tabelën më poshtë ndodhen fonde të deleguara për vitin 2024 për investime të cilat kanë filluar në vitin 2020, kanë vazhduar në vitin 2021-2023 dhe sipas kontratës përfundojnë në vitin 2024, ose janë në proces gjatë vitit 2025:

Nr.	Objekti kontratës	OE fitues	Vlera total kontrate me tvsh	Likuiduar deri me 31.12.2024	Mbetet për likuidim	Burim financimi
1	Permiresim te banesave ekzistuese per komunitete te varfera te pafavorizuara) viti 2021	N. shpk	20,323,310	15,813,640	4,509,670	M.F Dr,Strehimit
2	"Mirembajtje dhe pjese kembimi per mjetet (sherbim servisi)blerje vaj,filtra" bashkia prrenjas	D. L. pf	3,626,616	3,266,028	360,588	Fondet e veta
3	Per hartimin e planit te mbareshtimit te ekonomise pyjore sopot,bashkia prrenjas"	L. shpk	4,425,600	3,097,920	1,327,680	Fondet e veta
4	Permiresimin e kushteve te banesave per komunitetet e varfera dhe te pafavorizuar"	I. shpk	39,444,209	31,555,367	7,888,842	Fondet e veta
5	Gjelberim. Nëpërmjet pyllëz. I kurores se qytetit prrenjas	Al M W	10,584,173	2,616,278	7,967.895	M.Mjedisit
6	<b>TOTAL</b>		<b>78,404,717</b>	<b>56,349,233</b>	<b>22,054,675</b>	

Burimi: Drejtoria e Financës Bashkia Prrrenjas, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

**Për financimet nga Ministritë e linjës, FZHR dhe donatorë të tjerë**, për periudhën objekt auditimi, për kontratat e vitit 2024 në vlerën 169,276,940 lekë. Likuiduar në vitin 2024 vlera prej 83,612,678 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 85,664,262 lekë.

**Për financimet nga buxheti Bashkisë Prrenjas dhe Grande**, janë lidhur për periudhën objekt auditimi gjithsej 70 kontrata në vlerën 127,530,658 lekë. Likuiduar në vitin 2024 vlera prej 75,808,727 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 51,721,931 lekë.

**Grantet e specifike (602, 230+231) për vitin 2024:**

Nr.	Emërtimi objektit	Shuma gjithsej	Financuar buxhet shteti, FZHR, Te tjera	Financim ardhura veta
1	Blerje kamioni për mbetjet urbane (mjete teknologjik) granti nga ambasada e Japonisë	10,188,000	7,255,360	2,932,650
2	Blerje ushqime për qëndër ditore shtëpia e të moshuarve Bashkia Prrenjas	2,021,038	2,021,038	
3	Ndërtim i shkollës së mesme sali halili 3 kat, rrajcë fushë	151,856,222	129,077,789	22,778,433
4	Rikonstruksion i kanalit të xhelos faza 2 dhe sistemim i ujrave të larta në krastën e Prrenjasit	14,505,977	14,505,977	
5	Rikonstruksion i kanalit të lingajcës , faza II , fshati rrajcë, njësia administrative rrajcë, Bashkia Prrenjas	13,742,911	13,742,911	
6	Rikonstruksion i kanalit (kolektori lingajca) në fshatin rrajcë njësia administrative Rrajcë	2,693,508	2,693,508	

Burimi: Drejtoria e Financës Bashkia Prrenjas, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

**Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor 2024.**

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Prrenjas, bëhet mbështetur në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”;
- VKB-në nr.4, datë 27.12.2023 Për “Miratimin e Paketës Fiskale Vendore viti 2024”;

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore është si vijon:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Prrenjas për miratimin e paketës fiskale të vitit 2024;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet dhe familjarët, lidhur me taksat dhe tarifave vendore;
- Dokumentacioni i Drejtorisë së të Ardhurave, në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe dokumentacionit të tatim-paguesve;
- Kontrata, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Regjistrat dhe mbajtja e debitorëve për bizneset, për taksat dhe tarifave vendore;

- Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave;

### **Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së të Ardhurave (DA):**

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve u konstatua se, Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Prrenjas është përcaktuar në Vendimin e Kryetarit të Bashkisë, me nr. 09 datë 31.01.2024 ndryshuar me Vendimin nr. 149, datë 29.10.2024, ku Drejtoria e të Ardhurave ka kaluar në nivel Sektorial, ku në përbërjen e saj ka 5 punonjës, 1 Përgjegjës Sektori dhe 4 specialistë, të ndarë sipas tabelës më poshtë:

*Tabela nr. II.6: Struktura organizative e Drejtorisë së të Ardhurave sipas Urdhrit nr.9, datë 31.01.2024;*

<b>Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore</b>	<b>Struktura</b>	<b>Fakt</b>
Përgjegjës Sektori	1	1
Specialistë	4	4
<b>Punonjës gjithsej</b>	<b>5</b>	<b>5</b>

*Burimi: të dhëna nga Bashkia Prrenjas*

Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2024, DA ka funksionuar me strukturë të plotë, kjo në përputhje me strukturën organike, të miratuar me Vendimin nr. 149, datë 29.10.2024.

### **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:**

Për vitin 2024 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Prrenjas është miratuar me VKB-në nr. 4, datë 27.12.2023 për “Miratimin e paketës fiskale vendore, për vitin 2024”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr.68/1 Prot. datë.15.01.2024”. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Prrenjas paraqiten në aneks, në tabelën II.6.1. Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën II.6.1, për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Prrenjas paraqitet në masën 75%, nga 135,700,000 lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 101,279,930 lekë (34,420,070 lekë më pak), duke mos arritur objektivat e përcaktuara në planifikimin e vitit 2024.

Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave mund të ndikojë në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, përkatësisht:

- Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- VKB-në nr. 04, datë 27.12.2023 për “Miratimin e paketës fiskale vendore, për vitin 2024”;

Sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, kjo vjen për shkak të mos njohjes së situatës apo moskryerjes së rregullt të procedurave duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

### **Pajisja me autorizime të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Grupi i auditimit, auditori dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;

- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9 “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera”.

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Prrenjas, për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 7 subjekte, nga të cilët 5 subjekte ushtrojnë aktivitet me autorizimin përkatës, një subjekt nuk është i pajisur me autorizimin përkatës dhe një subjekt i ka mbaruar afati që prej datës 25.04.2023.

Tabela nr.II.6.3; subjektet që tregtojnë lëndë djegëse në Bashkinë Prrenjas, viti 2024.

Nr.	Subjekti	NIPT	Fillimi autorizimit	Mbarimi autorizimit	Detyrimi	Likujduar	Debitor	Shënime
1	K	J.....P	08.02.2024	0702.2029	1,100,000	1,000,000	100,000	Rinovuar 08.02.2024
2	L	J.....M	05.10.2020	04.10.2025	1,000,000	-	1,000,000	
3	K	L.....J	26.04.2018	25.04.2023	2,000,000	600,000	1,400,000	S'ka autorizim
4	G	K.....T	18.06.2021	18.06.2026	1,100,000	1,100,000	-	ok
5	M	K.....N	23.06.2022	22.06.2027	1,000,000	1,000,000	0	ok
6	B	L.....H	07.01.2022	10.01.2027	1,000,000	100,000	900,000	900,000 lehtë diferencë
7	A	M.....T			1,000,000	-	1,000,000	S'ka autorizim

Burimi: Drejtoria e të ardhurave.

Sipas tabelës më sipër dhe dokumentacionit ndodhur në dosjet respektive, rezulton se:

- Subjekti K. sh.p.k pas mbarimit të autorizimit, ka paraqitur kërkesë më datë 02.10.2023, për rinovim të tij. Nga ana e Bashkisë Prrenjas, më datë 05.10.2023 është kërkuar që subjekti të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm, sipas përcaktimeve ligjore.

Pas komunikimeve shkresore të sipërcituara, subjekti nuk është pajisur me autorizimin përkatës, duke krijuar të ardhura të munguara për Bashkinë Prrenjas në vlerën 1,000,000 lekë.

- Subjekti A. ushtron aktivitet tregtar pa u pajisur me autorizimin përkatës edhe pse nga ana e Bashkisë Prrenjas sipas shkresës me nr. 2093 prot., datë 06.08.2024 është kërkuar plotësimi dhe paraqitja e dokumentacionit sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, duke krijuar të ardhura të munguara për vitin 2024 në vlerën prej 1,000,000 lekë.

- Subjekti B. G, nga verifikimi i dosjes konstatohet se subjekti është pajisur me autorizim për tregtimin me pakicë të karburantit më datë 07.01.2022, për të cilin ka kryer pagesën prej 100,000 lekë më datën 10.01.2022.

Së pari, ligji e përcakton qartë se autorizimi lëshohet vetëm pas pagesës së plotë të detyrimit; Së dyti, bazuar në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9 përcaktohet se: “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera”. Në rastin e subjektit B.G, pagesa për autorizim është kryer në vlerën prej 100,000 lekë, sipas mandat

arkëtimit me nr. serial 05017 datë 10.01.2022 dhe jo në vlerën 1,000,000 lekë, duke krijuar të ardhura të munguara prej 900,000 lekë.

**Konstatim:** Ushtrimi i aktivitetit gjatë vitit 2024 të 5 subjekteve me tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse, apo pa likuiduar të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore, ka sjell të ardhura të munguara për bashkinë Prrenjas në vlerën prej 4,400,000 lekë. Këto detyrime të cilat konsiderohen të ardhura të munguara, janë krijuar nga mos zbatimi i përcaktimeve ligjore të sipërcituara, pasi subjektet duhej të pajiseshin me autorizimin përkatës vetëm pas kryerjes së plotë të pagesës prej 1,000,000 lekë.

*Për veprimet apo mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z.N.B Kryetar i Bashkisë Prrenjas, z.A.K në cilësinë e zv.Kryetar i Bashkisë Prrenjas, znj. M.V) në cilësinë e Drejtorit në Drejtorinë e të Ardhurave, I.G në cilësinë e Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, dhe znj. O.M në cilësinë e Specialiste Biznesi.*

### **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Bashkia Prrenjas në vitin 2023 ka patur në total 409 subjekte tregtarë, dhe gjatë vitit 2024 ka patur 438 subjekte ose 19 subjekte më shumë se viti 2023, nga të cilët 320 janë biznes i vogël dhe 118 operojnë si biznes i madh.

*Tabela nr.II.6.4; Numri i bizneseve në Bashkinë Prrenjas deri më datë 31.12.2024*

Nr	Lloji biznesit	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja gjatë vitit 2024	Mbyllur aktivitetin gjatë vitit 2024	Gjendja në fund të vitit 2024
1	Biznesi i madh viti 2024	97	21	2	116
2	Biznesi i vogël viti 2024	312	17	9	320
(1+2)	Gjithsej viti 2024	409	38	11	436

Burimi: Drejtoria e të ardhurave.

### **Taksat dhe tarifat e biznesit/familjare**

Në Bashkinë Prrenjas subjektet tregtarë ngarkohen me detyrime vendore për taksën e regjistrimit, mbi truallin, pasuri, pastrim, ndriçim, tarifën e gjelbërimit, etj., në tabelën në vijim paraqiten detyrimet e subjekteve në fund të vitit 2023, shtesat dhe pakësimet gjatë vitit 2024 si dhe detyrimi në fund të periudhës 2024;

*Tabela nr.II.6.5; Subjektet debitor nga 01.01.2024 deri më datë 31.12.2024;*

Nr.	Natyra e debitoreve	Debitor deri më 31.12.2023	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Debitor deri më 31.12.2024
1	Biznesi vogël	7,876,833	8,285,754	8,375,983	7,786,604
2	Biznesi i madh	13,817,215	33,737,742	31,290,899	16,264,058
1+2	Total	21,694,048	42,023,496	39,666,882	24,050,662

Burimi: Bashkia Prrenjas.

Sipas të dhënave të subjektit rezulton se deri më 31.12.2024 bizneset kanë krijuar një borxh prej 24,050,662 lekë detyrime, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për Bashkinë Prrenjas.

Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se Drejtoria e të Ardhurave nuk ka aplikuar penaltitetet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 114 ku përcaktohet se: “Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”, si dhe jo në përputhje me Paketën Fiskale të miratuar për vitin 2024, kapitulli IV.

Sa më sipër, grupi i auditimit përllogarit penaltitetet për subjektet debitor në vlerën prej 24,050,662 x 21.6 % = **5,267,094 lekë diferencë, e cila duhet të kontabilizohet në vijim.** Në

përfundim, bizneset kanë krijuar një borxh prej **29,317,757 lekë, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për Bashkinë Prrenjas.**

Tabela nr.II.6.6; Subjektet debitor për vitin 2024, përllogaritur nga grupi i KLSH-së; në lekë

Nr.	Kategoria	Detyrimet	Kamatvonesa 0,06% sipas KLSH	
<b>A</b>	Total Biznesi Vogël	7,786,604	1,705,266	9,491,870
<b>B</b>	Total Biznesi i Madh	16,264,058	3,561,828	19,825,886
	<b>Total Detyrime</b>	<b>24,050,662</b>	<b>5,267,094</b>	<b>29,317,757</b>

Burimi: Bashkia Prrenjas. përpunuar nga grupi auditimit.

*Për veprimet apo mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. M.V në cilësinë e Drejtorit në Drejtorinë e të Ardhurave, znj. O.M në cilësinë e Specialiste Biznesi dhe I.G në cilësinë e përgjegjësit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.*

### Taksat dhe tarifat familjare:

Në Bashkinë Prrenjas familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, tarifën e gjelbërimit, tarifën e pastrimit dhe tarifën e ndriçimit. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Prrenjas taksohen gjithsej 7757 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”. Në tabelën në vijim paraqiten në mënyrë të përmbledhur detyrimet e familjeve për taksat dhe tarifat vendore sipas njësive administrative, debitorët dhe pagesat e tyre;

Tabela nr.II.6.7: Familjet debitore për taksat dhe tarifat vendore në BP për vitin 2024 Lekë

Nr.	Nj.Adm	Nr. Famil.	Ngarkesa fiskale	Nr. fam. Paguear	Vl. e pag. 2024	Nr. Fam Debitore	Vl. debitore 2024	Debitorë 31.12.2023	Pagesa 2024	Vlera totale debitore progr.
<b>1</b>	Prrenjas	2221	6,373,095	657	1,979,660	1,564	3681906	17,525,664	2,329,569	19,589,530
<b>2</b>	Rrajcë	2522	6,009,166	993	2,327,260	1,529	3681906	14,434,865	2,661,337	15,455,434
<b>3</b>	Qukës	2297	3,933,231	492	805,467	1,805	3,127,764	12,319,111	949,576	14,497,299
<b>4</b>	Stravaj	717	901,100	199	207,860	518	693,240	6,368,817	714,378	6,347,679
<b>5</b>	<b>Total</b>	<b>7757</b>	<b>17,216,592</b>	<b>2341</b>	<b>5,320,247</b>	<b>5,416</b>	<b>11,893,947</b>	<b>50,648,457</b>	<b>6,654,860</b>	<b>55,889,942</b>

Burimi: Bashkia Prrenjas.

Sipas tabelës më sipër rezulton se vlera e borxhit e krijuar për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, nga familjarët rezulton të jetë në vlerën **11,893,947 lekë, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për Bashkinë Prrenjas.**

Vlera debitore e kategorisë “Familjar” për taksat dhe tarifat vendore, në krahasim me vitin 2023 ka rritje në vlerë të konsiderueshme. Kjo pasi në vitin 2023 debitorët e krijuar për këtë periudhë kanë qenë në vlerën 9,368,038 lekë ndërsa në vitin 2024 janë 11,893,947 lekë ose 2,525,909 lekë (21.2 %) më shumë.

Si përfundim, rezulton se në fund të vitit 2024 janë 5416 familje debitore, për një ose disa taksat dhe tarifa vendore, ç’ka do të thotë se 69,8 % e familjeve që taksohen/tarifohen janë debitorë.

### Dinamika e borxhit:

Nga auditimi konstatohet se, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2023 është në vlerën 91,432,408 lekë, vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2024 është 63,907,340 pakësimet gjatë vitit 2024 janë 57,543,302 lekë dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive në fund të vitit 2024 është në vlerën **97,796,446 lekë, duke përfshirë dhe asetet të cilat janë trajtuar më poshtë**

Sa më sipër, në krahasim me vitin 2023, borxhi është rritur me 6,364,038 lekë (rreth 7%), e cila mund të krijohet si rezultat i mos njoftimit në mënyrë të rregullt i individëve apo i subjekteve të cilët mund të mos jenë të vetëdijshëm për borxhin e krijuar.

Nr.	Debitor më 31.12.2023	Lëvizja viti 2024		
	Vlera	Shtuar	Pakësuar	Gjendje 31.12.2024
1	91,432,408	63,907,340	57,543,302	<b>97,796,446</b>

Burimi: Bashkia Prrenjas.

### Masat e marra për uljen e borxhit

Nga auditimi u konstatua se, dokumentacioni i vënë në dispozicion lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, Drejtoria e të Ardhurave ka njoftuar bizneset/familjarët debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifave vendore. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se për vitin 2024 për debitorët, u është drejtuar bankave të nivelit të dytë për bllokim të llogarive bankare për 19 subjekte për vlerën 10,565,446 lekë. Nga kjo shumë, janë arkëtuar vetëm 1,680,551 lekë (rreth 16%), të cilat paraqiten në kapitullin anekse, në tabelën II.6.8.

Drejtoria e të Ardhurave, pas dërgimit të njoftimeve për pagesat e taksave vendore, për subjektet që vijojnë të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, masat e marra nga ana e DA nuk duhen të ndalen por duhet të vijojnë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. Masat e ndërmarra për uljen e borxhit janë të pjesshme dhe jo mjaft efektive.

*Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: znj. M.V në cilësinë e Drejtorit në Drejtorinë e të Ardhurave, znj. O.M në cilësinë e Specialiste Biznesi dhe I.G në cilësinë e përgjegjësit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.*

### Taksa e tokës bujqësore:

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, “Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën vetë deklaratimet e sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka”, ku është e ndarë në 8 kategori që kanë nivele të ndryshme takse për ha/vit si më poshtë:

Tabela nr.II.6.9; Vlera e taksës së tokës bujqësore sipas ligjit, në lekë/hektar/vit;

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas ligjit (lekë/ha/vit)
I	2800
II	2100
III	1400
IV	1350
V	1250
VI	1200
VII-X	1100

Burimi: Ligji 9632 datë 30.10.2006.

VKB-në nr.4, datë 27.12.2023 Për “Miratimin e Paketës Fiskale Vendore viti 2024”, kapitulli I, pika 2.b, taksa mbi tokën bujqësore, janë miratuar nën kategorizimet për taksën e tokës bujqësore sipas përcaktimeve ligjore të sipërcituara.

Referuar VKB-së përgjegjësinë për vjeljen e kësaj takse e ka Drejtoria e të Ardhurave. Për vitin 2024 sipas evidencës Plan-Fakt, taksa mbi tokën bujqësore është realizuar në nivelin 71.2% (planifikuar 3,886,000 lekë për 5223 familje dhe realizuar 2,765,330 lekë).

Në tabelën më poshtë paraqiten detyrimet dhe pagesat e familjeve të cilat janë objekt i pagesës së taksës së tokës bujqësore:

Tabela nr.II.6.10: Debitorët për tokën bujqësore sipas njësite administrative

në lekë

Numri Rendor	Njësitë Administrative	Familje Aktualisht	Sipërfaqja Tokës Gjithsej (m <sup>2</sup> )	Taksa e Tok. Bujq. (Lekë)	Numri Familjeve që kanë paguar	Vlera e Taksës e paguar (lekë)	Numri Familjeve Debitorë	Shuma Debitorë
1	Prenjas	506	4,716,616	480,965	190	152,318	316	328,647
2	Rrajcë	1956	12,317,605	1,516,219	796	580,796	1,160	935,423
3	Qukës	2052	4,537,816	1,477,100	475	327,371	1,577	1,149,729
4	Stravaj	709	10,822,372	453,765	197	93,695	512	360,070
	<b>TOTALI</b>	<b>5223</b>	<b>32,394,409</b>	<b>3,928,049</b>	<b>1658</b>	<b>1,154,180</b>	<b>3565</b>	<b>2,773,869</b>

Burimi i të dhënave: Drejtoria e të Ardhurave përpunuar nga grupi auditimit.

Sa më sipër konstatohet se nuk është bërë planifikim i saktë i taksës së tokës bujqësore. Për këtë sasi toke të ndarë, planifikimi i kësaj takse për një vit ushtrimor duhej të ishte në vlerën **3,928,049 lekë**, por në fakt nga Drejtoria e të Ardhurave, është planifikuar në vlerën prej **3,886,000 lekë**, duke mos parashikuar edhe arkëtime nga detyrime të mëparshme.

Veprimet e më sipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 5, gërma (a): “Në hartimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme”, si dhe gërma (e): “Detyrimet tatimore të pa mbledhura në kohë, prej më shumë se 18 muaj nga afati i caktuar në legjislacionin në fuqi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore, nuk përfshihen në parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në projektbuxhetin për vitin buxhetor pasardhës. Përdorimi i të ardhurave shtesë nga mbledhja e detyrimeve tatimore të pa mbledhura në kohë i nënshtrohet procesit të rishikimit të buxhetit vjetor, sipas përcaktimeve të nenit 46 të këtij ligji”.

Nga Drejtoria e të Ardhurave nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave, për arsye se nuk janë parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve të mëparshme (për vitin 2024 pagesa për detyrimet e mëparshme janë në vlerën prej 1,611,150 lekë).

Sa i përket debitorëve për tokën bujqësore, për vitin 2024, për 4 njësit administrative rezulton të jetë në vlerën **2,773,869 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Prrenjas**.

Gjithashtu, në regjistrin e debitorëve familjarë me datë 31.12.2024 konstatohen 42 punonjës të Bashkisë Prrenjas, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet për taksën e tokës, sipas tabelës II.6.11, ndodhur në aneks.

Vlera debitorë e krijuar nga **42 punonjës të Bashkisë Prrenjas është në vlerën 499,923 lekë**. Rrjedhimisht, mundësia e arkëtimit të tyre nga titullari i Bashkisë Prrenjas dhe Drejtoria e të Ardhurave është e mundur.

Kjo situatë krijon një precedent të papranueshëm, ku ata që janë të punësuar në administratën vendore Prrenjas dhe marrin pagë nga fondet publike, vetë nuk i përmbushin detyrimet e tyre ligjore për pagesat e taksave dhe tarifave vendore. Një sjellje e tillë dëmton besimin e qytetarëve, cënon barazinë para ligjit dhe dobëson përpjekjet për rritjen e të ardhurave. Administrata e përgjegjshme, duhet të jetë gjithmonë në zbatim të ligjit dhe të japë shembullin më të mirë për qytetarët e saj.

Sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi kryetari i Bashkisë Prrenjas z. N.B dhe të gjithë punonjësit të pasqyruar në Tabelën nr.II.6.11: Punonjësit e BP debitor për taksën e tokës bujqësore, në kapitullin Aneks.

### **Taksa e ndikimit në infrastrukturë.**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenit 27, pika 2/1 “Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit.” dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e Aluizni-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.

Në Bashkinë Prrenjas struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Duke u bazuar në të dhënat që disponon kjo drejtori në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se për vitin 2024 janë legalizuar 22 objekte me vlerë pagese për të kryer prej 654,961 lekë, të cilët kanë konkluduar në pagesën prej 451,780 lekë duke **krijuar të ardhura të munguara për vitin 2024 në vlerën prej 203,181 lekë.**

Tabela nr.II.6.12: Lejet e legalizimit dhe vlera e taksës në lekë

Periudha	Nr. i lejeve të legalizimit	Vlera e taksës (lekë) (0.5% e Vl. Inv.)	Pguar	Debitor 01.01-31.12.2024	Debitor progresiv në fund 2024
01.01-31.12.2024	22	654,961	451,780	203,181	2,046,409

Burimi: Bashkia Prrenjas.

Për Bashkinë Prrenjas, sipas të dhënave vënë në dispozicion grupit të auditimit, konstatohet se të ardhurat e munguara për TNI për vitin 2024 janë shtuar në vlerën 203,181 lekë. Në fund të vitit 2023 debitorët për TNI ishin në vlerën 1,843,228 të cilat i përkasin viteve të mëparshme dhe në fund të vitit 2024 vlera progresive është 2,046,409 lekë.

### **Taksa vjetore e mjeteve të transportit rrugor**

Sipas VKB-së nr.4, datë 27.12.2023 Për “Miratimin e Paketës Fiskale Vendore viti 2024”, si agjent tatimor për vjeljen e kësaj takse është përcaktuar “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor (DRSHTRR)”, e cila derdh me anë të faturës për arkëtim përqindjen e përcaktuar të totalit mujor të të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit.

Nga rakordimet mujore të bëra me këtë drejtori, konkludohet se realizimi i të ardhurave nga taksa e mjeteve të përdorura për vitin 2024 është 11,861,483 lekë, ose 11,7% e të ardhurave totale për Bashkinë Prrenjas.

Nga auditimi konstatohet se për vitin 2024 agjenti tatimor DRSHTRR rezulton debitor në vlerën prej **3,072,588 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar.**

Për këtë agjent, Bashkia Prrenjas duhet të llogarisë gjobë në masën 0.06% për çdo ditë vonese, por jo për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike, në bazë të ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 117, pika a, ku citohet: “Agjenti i mbajtjes së tatimit, agjenti i taksave apo ai i tarifave detyrohen të paguajnë gjobë, në masën e mëposhtme:

- a) Gjobë në masën 0,06 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës, në rast se e ka mbajtur, llogaritur dhe deklaruar tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën, por nuk e ka transferuar atë në Buxhetin e Shtetit. Ky dënim aplikohet për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo për një

*periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.”*

**Konkluzion: të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrenjas, për vitin 2024 janë:**

- Familjaret debitor, janë në vlerën **11,893,947** lekë;
  - Nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën **203,181** lekë;
  - Mos aplikimi i penaliteteve par subjektet debitor, në vlerën prej **5,267,094** lekë;
  - Nga Autorizimet e karburanteve, në vlerën prej 4,400,000 lekë;
  - Taksa e tokës bujqësore në vlerën **2,773,869** lekë;
  - Agjenti tatimor DRSHTRR, në vlerën **3,072,588** lekë;
- Në total 27,610,679 lekë.**

*Për sa trajtuar më sipër, nga ana e subjektit të audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.794/33 prot. datë 06.10.2025, nga z.A.G, znj.O.M dhe z.A. O, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:**- Në datën 13.06.2025, jemi njohur me akt konstatimin nr.4 mbi auditimi nga auditimi kryer mbi subjektet që nuk kanë likuajuar detyrimet tatimore deri më datë 31.12.2024 po ju paraqesim bashkëlidhur po ju dërgojmë fotokopje të dokumentacionit përkatës të likujdimit. Gjithashtu edhe vlera debitore e agjentit tatimor prej 3,072,588 lekë është likuajuar ne vitin 2025 si dhe është kryer kontabilizimi saj...

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Sa më sipër, subjekti nuk ka observim në lidhje me gjetjet e grupit të auditimit por ka vepruar duke marrë masat përkatëse për sistemimin dhe përmirësimin e situatës.

### **2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar.**

- Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.
- Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.
- Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës.
- Auditim mbi procedurat e inventarizimit.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar,, si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2024 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar,, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.

Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).

Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.

Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).

Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).

Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat Financiare të Bashkisë Prrenjas për vitin ushtrimor 2024 janë të nënshkruara nga z. N.B. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. S.K. me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Librazhd me shkresën nr. 497 prot., datë 27.02.2025, brenda afatit ligjor.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara sa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin e rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

-Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

-Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

-Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësi, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj..

-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Prrrenjas për aktivitetin ekonomiko-financiar për periudhën 01.01.2024- 31.12.2024.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

### **Procesi i inventarizimit:**

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2024 konstatohet se, në lidhje me procesin e inventarizimit është proceduar si më poshtë.

-Me Urdhrin nr. 444 datë 03.10.2024 të Kryetarit të Bashkisë me objekt “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve të bashkisë dhe materialeve në çdo njësi administrative të Bashkisë Prrenjas” janë ngritur komisionet si më poshtë;

Njësia Administrative Rrajcë, komisioni i përbërë nga; z. E.D kryetar i komisionit dhe anëtarët, znj. E. B., Znj. J. B dhe z. I.G.

Njësia Administrative Qukës, komisioni i përbërë nga; z. Y.K kryetar i komisionit dhe antarët, znj. B.K, z. A. M dhe z. L.K.

Njësia Administrative Stravaj, komisioni i përbërë nga; z. A.E kryetar i komisionit dhe anëtarët, znj. E. N., z. M.Z dhe z. L.T.

Bashkia, Bordi i Kullimit, Drejtoria Pyjore, Stacioni i Shërbimit MZSH, komisioni i përbërë nga; z. A. B. kryetar i komisionit dhe anëtarët, znj. O.M, znj. E.K dhe znj. R. R.

Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, komisioni i përbërë nga; z. EV kryetar i komisionit dhe anëtarët, z. A.G, z. B.O, znj. M.K dhe z. D.K.

Inventarizimi i Aktiveve, komisioni i përbërë nga; z. M.A kryetar i komisionit dhe anëtarët z. L. L, z. S.H, z. Sh.H, z. B.O, znj. J.B.

Me vendimi nr. 115, datë 26.12.2024 i Këshillit Bashkiak “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të Bashkisë Prrenjas për vitin 2024” është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit e materialeve të Bashkisë Prrenjas me një vlerë totale 7,341,657 lekë të cilat nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2024, pasi nuk është shprehur ligjshmëria nga Prefekti i qarkut Elbasan. Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2024, të pozicionit financiar të Bashkisë Prrenjas, formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2024, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, ato paraqiten si më poshtë:

Lekë

<b>Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasivet</b>	<b>18,848,418,604</b>
Aktivet	19,184,424,310
Pasivet	336,005,706
Aktivet Neto	18,848,418,604

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Lekë

<b>Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2024</b>	<b>593,834,883</b>
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”	237,604,855
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”	58,900,082
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”	297,329,946

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

## A. AKTIVET

### I. Aktivet Afat Shkurtra

#### 1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
531	Mjete monetare ne arkë			
512,56	Mjete monetare në bankë			
520	Disponibilitete në thesar	237,089,210	190,338,038	46,751,172
50	Letra me vlerë			
532	Vlera të tjera	515,645	372,610	143,035
54	Akreditiva dhe paradhënie			

59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë			
<b>Totali</b>				

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 190,338,038 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 237,089,210 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 267,205,176 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 38,675,760 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 49 dhe pika 50.

-Llogaria 532 “Vlera të tjera” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 372,610 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 515,645 lekë me një shtesë në vlerën 143,035 lekë e cila përfaqëson letrat me vlerë të Gjendjes Civile dhe blloqe biletarie për ushtrim aktiviteti tregtar.

2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
31	Materiale	25,824,235	10,968,007	14,856,228
32	Inventar i imët	31,607,016	24,074,419	7,532,597
33	Prodhime, punime e shërbime në proces			
34	Produkte			
35	Mallra	1,468,831	1,749,126	-280,295
36	Kafshë në rritje e majmëri			
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarit (-)			
<b>Totali</b>		58,900,082	36,791,552	22,108,530

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 58,900,082 lekë dhe përbëhen nga; llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 25,824,235 lekë; llogaria 32 “Inventar i imët” 31,607,016 lekë dhe llogaria 35 “Mallra” në vlerën 1,468,831 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 22,108,530 lekë.

Kjo kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.

-Llogaria 31 “Materiale”, ka vlerën 25,824,235 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2024	10,968,007
Shtesa	50,041,812
Pakësimi	35,185,584
Gjendja në 31.12.2024	25,824,235

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

-Llogaria 32 “Inventarë i imët”, ka vlerën 31,607,016 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2024	24,074,419
Shtesa	9,959,260
Pakësimi	2,426,663
Gjendja në 31.12.2024	31,607,016

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

-Llogaria 35 “Mallra”, ka vlerën 1,749,126 lekë në 31.12.2023 dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 janë shtesa 5,832,795 lekë dhe pakësimi në vlerën 6,113,090 leke dhe gjendja në 31.12.2024 është 1,468,831 leke paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2024	1,749,126
Shtesa	5,832,795
Pakësimi	6,113,090
Gjendja në 31.12.2024	1,468,831

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

### 3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” :

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba			
431	Tatime e taksa			
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal			
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti			
435	Sigurime Shoqërore			
436	Sigurime Shëndetësore			
437,438	Organizma të tjerë shoqërore			
44	Institucione të tjera publike			
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes			
468	Debitorë të ndryshëm	97,815,946	94,462,552	3,353,394
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	199,514,000	101,103,958	98,410,042
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit			
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)			
	<b>Totali</b>	<b>297,329,946</b>	<b>195,566,510</b>	<b>101,763,436</b>
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Parapagime			
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin			
477	Diferenca konvertimi aktive			
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime			
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	1,320,672	-1,320,672
	<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>1,320,672</b>	<b>-1,320,672</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 94,462,552 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më date 31.12.2024, në vlerën 97,815,946 lekë me një rritje në vlerën 3,353,394 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2024	94,462,552
Shtesa	64,896,696

Pakësimi	61,543,302
Gjendja debitore në 31.12.2024	97,815,946

Lekë

Debitorë subjekte dhe individë	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Debitor Biznesi	23,294,048	42,023,496	39,866,882	25,450,662
Debitor taksa e tarifa	50,648,457	17,216,592	11,975,107	55,889,942
Debitor uji pijshëm	13,138,087	977,356	857,664	13,257,779
Debitor kopsht çerdhe	1,336,668	4,012,291	4,093,336	1,255,623
Debitorë Legalizime	2,037,792	654,961	750,313	1,942,440
Gjoha policia Bashkiake	7,500	12,000	0	19,500
Gjoha IVMT	4,000,000	0	4,000,000	0
<b>Totali</b>	<b>94,462,552</b>	<b>64,896,696</b>	<b>61,543,302</b>	<b>97,815,946</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Të dhënat në mënyrë të përmbledhur debitorët nga taksat dhe tarifat vendore të përfshira në llogarinë 468, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Nr.	Debitorët	Situata debitore më datë 31.12.2024
1	Abonentët familjarë	55,889,942
2	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	1,942,440
3	Subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe nënproduktet e tyre	1,400,000
4	Dhënia me qira truallit për vendosjen e antenave	220,360
	<b>Totali</b>	<b>59,452,742</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë; vlera 3,072,588 lekë e cila i përket debitorit DPSHTRR dhe nuk janë pasqyruar gjocat e IMTV në vlerën 5,020,000 lekë.

Në relacionin e datës 6.01.2025, të IVMT Bashkia Prrenjas nënshkruar nga K/inspektorë Egerem Karriqi, inspektorët Gazment Cuku dhe Edmond Duni, drejtuar Drejtorisë së Menaxhimit dhe Planifikimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale është pasqyruar vlera e masave administrative në shumën 5,020,000 lekë që duhet të zbritet nga llogaria e debitorëve të vitit 2024 me argumentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 127 datë 19.12.2024 “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 01 Janar 2015 deri më 30 Nëntor 2024 nga Inspektoratet vendore të mbrojtjes së territorit, Inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit, Autoriteti kombëtar i ushqimit, Inspektorati shtetëror shëndetësor, si dhe Policia e shtetit dhe ajo Bashkiake”.

Nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit dhe Planifikimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale janë hequr nga lista e debitorëve në datën 31.12.2024 vlera e masave administrative të pa ekzekutuara deri në datë 31.12.2023, që janë në shumën 4,000,000 lekë ndërsa vlera e debitorëve prej 1,020,000 lekë nuk është pasqyruar fare në kontabilitet. Sa trajtuam më sipër, Bashkia Prrenjas duhet të vepronte pas daljes së VKM-së Nr.274, datë 9.5.2025 dhe në përputhje me përcaktimet e VKM-së.

Debitorët në vlerën 8,092,588 lekë(3,072,588+5,020,000), nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2024. Nga këto debitorët në vlerën 3,072,588 lekë nuk janë përfshirë nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në rakordinin e bërë me Sektorin e Kontabilitetit. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtorisë së Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale. Veprime këto në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin

*financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja “ë”; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.

Gjithashtu konstatohet se marrëdhënia shkresore midis strukturave të bashkisë që ka të bëjë me rakordimet në lidhje me debitorët është bërë me shkresa të pa protokolluara në zyrën e protokoll arshivës, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, neni 22. Në mënyrë që të gjitha këto shkresa të kthehen në akte zyrtare dhe të kenë fuqi juridike duhet të kenë tërësinë e elementeve të përcaktuara ligjërisht në nenet 11-20 të “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Për veprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore), pasi në listën e dërguar me shkresë përcjellëse me nr. 300 prot., datë, 31.01.2025 në Drejtorinë e Financës, mungojnë debitorët e sipër cituar.

- IVMT Bashkia Prrenjas e cila me shkresën e datës 06.01.2025, drejtuar Drejtorisë së Menaxhimit dhe Planifikimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale ka pasqyruar masat administrative në vlerën 5,020,000 lekë që duhet të zbritet nga llogaria e debitorëve të vitit 2024 me argumentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 127 datë 19.12.2024.

- Nga auditimi konstatohet se, në pasiv të bilancit është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje të ardhura për t’u marrë” me kundër parti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.

*Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Prrenjas është paraqitur observacioni nëpërmjet shkresës me Nr. 794/33 prot., datë 06.10.2025, protokolluar në KLSH me shresën nr. 403/6. prot., datë 08.10.2025. nga znj. S.K Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit dhe Planifikimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale dhe znj. B.K Përgjegjës i Kontabilitetit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:** Në lidhje me llogarinë 468(Debitorë të ndryshëm) vlera 168,722 lekë si detyrim i kontratave të qirasë të fondit pyjor nuk është paraqitur nga Drejtoria e Pyjeve asnjë dokument pranë zyrës së Financës për tu kontabilizuar në pasqyrat financiare dhe nga periudha e mëparshme nuk kishte vlerë debitorë për këtë zë.

Në lidhje me debitorët e taksave dhe gjobat e IVMT-së kemi paraqitur vlerën e debitorëve sipas listës me nr. 300 prot., datë 31.01.2025 të nënshkruar nga zyra e Tatim Taksave me përgjegjës z. I.G dhe shkresës nga zyra e IVMT, datë 06.01.2025 të nënshkruar nga punonjësit e IVMT-se z. E.K si Kryeinspektor, z. G.C si inspektor dhe z. Edmond Duni si inspektor.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër në lidhje me pretendimet e paraqitura nga ana e Drejtorisë së Financës, observacionet janë të karakterit justifikues dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit

Llogaria 4342 “Operacion me shtetin (të drejta)” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 101,103,958 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më date 31.12.2024 në vlerën 199,514,000 lekë me një shtesë në vlerën 98,410,042 lekë. Lëvizja e llogarisë paraqitet në pasqyrën si vijon:

Lekë

<b>Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”</b>	
Çelje e vitit 2024	101,103,958
Shtesa	653,667,709
Pakësimi	555,257,667
<b>Gjendja debitorë në 31.12.2024</b>	<b>199,514,000</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Nga analiza e mësipërme llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” është paraqitur saktë dhe kuadron me llogaritë e klasës 4. Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

## II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 21 “Aktive afatgjata materiale”, 25-26 “Aktive afatgjata financiare” dhe 23 “Investime në proces” përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
	II. Aktive Afatgjata	18,590,589,427	1,340,015,440	17,250,573,987
20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	8,755,579	11,899,243	-3,143,664
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave			
202	Studime dhe kërkime	8,755,579	11,899,243	-3,143,664
203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme			
21	2. Aktive Afatgjata materiale	18,498,845,781	1,195,497,819	17,303,347,962
210	Toka, Troje, Terrene	4,918,360	4,918,360	0
211	Pyje, Plantacione	17,349,552,179	24,118,659	17,325,433,520
212	Ndërtesa e konstruksione	544,543,702	618,437,942	-73,894,240
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	545,370,288	501,633,730	43,736,558
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	7,235,127	8,203,353	-968,226
215	Mjete transporti	25,490,072	19,127,590	6,362,482
216	Rezerva shtetërore			
217	Kafshë pune e prodhimi			
218	Inventar ekonomik	21,736,053	19,058,185	2,677,868
24	Aktive afatgjata të dëmtuara			
28	Caktime të aktiveve afatgjata			
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	280,000		280,000
25	Huadhënie e nen huadhënie			
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	280,000	0	280,000
	4. Investime	82,708,067	132,618,378	-49,910,311
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale			
231	Për Aktive Afatgjata materiale	82,708,067	132,618,378	-49,910,311

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

### 1. Aktivët Afatgjata Jo Materiale.

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 11,899,243 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 2,602,793 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 3,469,454 lekë ka pasur pakësim në vlerën 2,277,003 lekë, vlerë e cila ka kaluar në llog. 213 dhe më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 8,755,579 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	11,899,243
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	Gjendja në 01.01.2024	11,899,243
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	2,602,793
	5	Amortizim shtesës	5,401,789
	6	Pakësimi gjatë vitit 2024 (K)	2,277,003
	7	Amortizim nga pakësimi	1,932,335
	4	Kosto historike	12,225,033
	5	Amortizim i akumuluar	3,469,454

	6	Gjendja më datë 31.12.2024	8,755,579
--	---	----------------------------	-----------

## Lekë

Studime-Projektme(kosto historike)	Gjendja 01.01.2024	Shtesa	Pakësime	Amortizimi I akumuluar	Gjendja 31.12.2024
Objekte inventari					
Studime Projektme Njësia Stravaj Viti 2007	117,980		117,980		
Studime Projektme Njësia Stravaj Viti 2013	650,020		650,020		
Hartim Projekti Rruga Lagje E Re Rrajce Viti 2008	44,600		44,600		
Hartim Projekti Tregu Hunda Rrajce Viti 2008	38,117		38,117		
Hartim Projekti Liqenet E Likopathres Njësia Rrajce Viti 2008	18,000			16,664	1,336
Hartim projekti Rrethim I Shkollës Mesme Rrajce Viti 2008	28,000			25921	2,079
Studime Projektme Njësia Rrajce Viti 2013	1,176,816		1,176,816		
Projekt Rikonstruksioni Rruga Pishkash Njësia Qukes Viti 2009	17,300		17,300		
Studime Projektme Njësia Qukes Viti 2010	232,170		232,170		
Hartim Projekti Kuz - Prrrenjas Viti 2021-2022	5,157,600			1,810,546	3,347,054
Hartim Projekti Ujësllësi Urake - Kotodesh - Katjel 2021-2022	4,418,640			1,616,323	2,802,317
Projekti Shkollës Dilaver Nezha Viti 2024		2,602,793			2,602,793
<b>Totali</b>	<b>11,899,243</b>	<b>2,602,793</b>	<b>2,277,003</b>	<b>3,469,454</b>	<b>8,755,579</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrrenjas.

Nga auditimi konstatohet se në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” janë përfshirë projekte me objekt; Hartim projekti KUZ Prrrenjas, Hartim projekti; ujësllësi Urakë, Kotodesh, Katjel; Hartim projekti i digës liqenet e Likopathrës dhe Hartim projekti rrethim i shkollës së mesme Rrajcë, në vlerën 9,622,240 lekë (kosto historike) të cilat nuk janë kontabilizuar drejt, pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e investimit, për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është pasqyruar saktë. Veprime këto në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5.

*Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Prrrenjas është paraqitur observacioni nëpërmjet shkresës me Nr. 794/33 prot., datë 06.10.2025, protokolluar në KLSH me shresën nr. 403/6 prot., datë 08.10.2025 nga znj. S.K Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit dhe Planifikimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale dhe znj. B.K Përgjegjës i Kontabilitetit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:** Në lidhje me llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” për projektet me objekt: Hartim projekti KUZ Prrrenjas dhe Ujësllësi Urakë Kotodesh Katjel kemi bërë transferimin e vlerës së tyre Shoqërisë Rajonale Ujësllësi Kanalizime Pogradec me shkresën nr. 581 prot., datë 07.03.2025 bashkë me fletë-daljet nr. 211, 212, datë 06.03.2025 dhe aktin e marrjes në dorëzim nr. 248/1 prot., datë 26.03.2025 të SH.A Pogradec një kopje e te cilave ju është venë në dispozicion gjatë periudhës së audituar. Në lidhje me projektet, hartim projekti i digës liqenet e Likopathrës dhe hartim projekti i rrethimit të shkollës Rrajcë janë projekte të cilat duheshin bashkangjitur investimeve nga ish-komuna Rrajcë që në vitet 2008 kur ishte bërë investimi i tyre. Veprime të periudhave të mëparshme që mbetet për tu sistemuar në vazhdim.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër në lidhje me pretendimet e paraqitura nga ana e Drejtorisë së Financës, Bashkia Prrrenjas, observacionet janë të karakterit justifikues dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.

## 2. Aktivet Afatgjata Materiale

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 4,918,360 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa/pakësim, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,918,360 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	4,918,360
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	Gjendja në 01.01.2024	4,918,360
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësimi gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimi	0
	4	Kosto historike	4,918,360
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	4,918,360

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

-Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 24,118,659 lekë(kosto historike). Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 17,325,433,520 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 17,349,552,179 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	24,118,659
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	Gjendja në 01.01.2024	24,118,659
	4	Shtesa gjatë vitit 2024	17,325,433,520
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësimi gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimi	0
	4	Kosto historike	17,349,552,179
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	17,349,552,179

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

-Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” në datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 748,627,019 lekë(kosto historike). Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 31,274,298 lekë pakësimi në vlerën 76,594,719 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 158,762,896 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 544,543,702 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	748,627,019
	2	Amortizim i akumuluar	130,189,077
	3	Gjendja në 01.01.2024	618,437,942
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	31,274,298
	5	Amortizim shtesë	30,921,897

	6	Pakësimi gjatë vitit 2024 (K)	76,594,719
	7	Amortizim nga pakësimi	2,348,078
	4	Kosto historike	703,306,598
	5	Amortizim i akumuluar	158,762,896
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	544,543,702

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrrenjas.

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 933,787,484 lekë(kosto historike). Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 70,750,580 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 459,167,776 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 545,370,288 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	933,787,484
	2	Amortizim i akumuluar	432,153,754
	3	Gjendja në 01.01.2024	501,633,730
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	70,750,580
	5	Amortizim shtesë	27,014,022
	6	Pakësimi gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimi	0
	4	Kosto historike	1,004,538,064
	5	Amortizim i akumuluar	459,167,776
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	545,370,288

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrrenjas.

Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” konstatohet se, në këtë llogari Bashkia Prrrenjas ka në inventarë aktive në vlerën kontabël 240,034,568 lekë që u përkasin objekteve që kanë të bëjnë me Ndërmarrjen e Ujësjetllës Kanalizimeve, Bashkia Prrrenjas (sot pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec me Nipt. M24416601U). Nga të dhënat e paraqitura nga Bashkia Prrrenjas rezulton se transferimi në Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec në vlerën 479,174,591 lekë, është bërë për vlerë të mbetur dhe jo për vlerën sipas koston historike. Gjithashtu transferimi është bërë jo për të gjithë zërat që i përkasin ujësjetllësve sipas regjistrit ekzistues të aktiveve por vetëm për disa zëra. Nga të dhënat e sektorit të financës për aktivet në vlerën 240,034,568 lekë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Prrrenjas.

Nga auditimi konstatohet se, nga ana e Bashkisë Prrrenjas nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të saktë të dorëzimit të aktiveve Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec. Nuk janë hartuar procesverbale të sakta të dorëzimit dhe marrjes në dorëzim midis dy institucioneve. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-36.

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” në datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 18,234,724 lekë(kosto historike). Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,984,700 lekë pakësim nga nxjerrje jashtë përdorimit në vlerën 902,088 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 12,082,209 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 7,235,127 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën në vijim:

## Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”, Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	18,234,724
	2	Amortizim i akumuluar	10,031,371
	3	Gjendja në 01.01.2024	8,203,353
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	1,984,700
	5	Amortizim shtesë	2,050,838
	6	Pakësimi gjatë vitit 2024 (K)	902,088
	7	Amortizim nga pakësimi	
	4	Kosto historike	19,317,336
	5	Amortizim i akumuluar	12,082,209
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	7,235,127

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrrenjas.

-Llogaria 215 “Mjete transporti” në datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 45,266,396 lekë (kosto historike). Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 10,188,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 29,964,324 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 25,490,072 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

## Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 215 “Mjete transporti” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	45,266,396
	2	Amortizim i akumuluar	26,138,806
	3	Gjendja në 01.01.2024	19,127,590
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	10,188,000
	5	Amortizim shtesë	3,825,518
	6	Pakësimi gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimi	0
	4	Kosto historike	55,454,396
	5	Amortizim i akumuluar	29,964,324
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	25,490,072

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrrenjas.

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 43,627,145 lekë (kosto historike). Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 7,072,089 lekë, pakësimi nga nxjerrja jashtë përdorimit në shumën 582,584 leke dhe amortizim të akumuluar në vlerën 28,380,597 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 21,736,053 lekë. Analiza e detajuar e lëvizjes së llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

## Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 218 “Inventar ekonomik” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	43,627,145
	2	Amortizim i akumuluar	24,568,960
	3	Gjendja në 01.01.2024	19,058,185
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	7,072,089
	5	Amortizim shtesë	3,811,637
	6	Pakësimi gjatë vitit 2024 (K)	582,584
	7	Amortizim nga pakësimi	0
	4	Kosto historike	50,116,650
	5	Amortizim i akumuluar	28,380,597
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	21,736,053

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrrenjas.

Në mënyrë analitike të dhënat për llogaritë e aktiveve paraqiten si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Prrenjas	Njësia administrative Rrajce	Njësia administrative Stravaj	Njësia administrative Qukes	Njësia Administrative	Jashtë përdorimet	Amortizimi total	Totali
210		4,918,360						4,918,360
211	11,801,906		17,337,750,273					17,349,552,179
212	477,327,938	75,479,087	23,442,476	127,057,097			158,762,896	544,543,702
213	359,858,385	152,247,556	67,904,318	378,729,248	45,798,557		459,167,776	545,370,288
214	13,137,157	1,264,018	671,193	5,147,056		902,088	12,082,209	7,235,127
215	55,454,396						29,964,324	25,490,072
218	19,334,950	11,473,099	1,630,241	18,260,944		582,584	28,380,597	21,736,053
<b>Totali</b>	<b>936,914,732</b>	<b>245,382,120</b>	<b>17,431,398,501</b>	<b>529,194,345</b>	<b>45,798,557</b>	<b>1,484,672</b>	<b>688,357,802</b>	<b>18,498,845,781</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Nga auditimi i llogarive të pasqyruara më sipër dhe krahasimi i analizës në kontabilitet me analizën sipas gjendjes fizike konstatohet se:

a. Në gjendjen e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” në vlerën 17,349,552,179 lekë (kosto historike) është përfshirë vlera 6,969,028 lekë (kosto historike) e cila është e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga vitet e mëparshme. E pa analizuar, kjo vlerë, ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Veprime këto në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

*Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Prrenjas është paraqitur observacioni nëpërmjet shkresës me Nr. 794/33 prot., datë 06.10.2025, protokolluar në KLSH me shresën nr. 403/6 prot., datë 08.10.2025 nga znj. S.K Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit dhe Planifikimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale dhe znj. B.K Përgjegjës i Kontabilitetit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:** Në lidhje me konstatimin për llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione” Vlera 6,969,028 lekë në regjistrin e aktiveve dorëzuar nga punonjësit e mëparshëm me emërtimin:

- Investim dru zjarri 1,294,080 lekë, viti 2018.
- Prodhim, transport, stivim në fushën e Bashkisë dru zjarri 5,674,948 lekë, viti 2019.

Në lidhje me këto dy zëra në inventarin e aktiveve nga komisioni i ngritur nga Kryetari i Bashkisë me urdhrin nr. 444 datë 03.10.2024 “Për Inventarin e Aktiveve të Bashkisë nga anëtarët e komisionit të Drejtorisë së Pyjeve del si problem se këto dy zëra nuk ishin si aktive gjendje pranë kësaj Drejtorie pasi sipas tyre kishin qenë dru zjarri të cilat ishin shpërndarë institucioneve të bashkisë me fletë- dalje të magazinës së materialeve sipas plan-shpërndarjeve përkatëse në vitet që ishin kryer. Gabimisht këto vlera kanë kaluar në llogarinë 211( pyje, kullota, plantacione) dhe jo në llogarinë 602( dru zjarri). Për këtë veprim nga kjo drejtori duhet një informacion më i detajuar në lidhje me dokumentacionin e këtyre dy investimeve për të bërë vërtetimin e saktë në lidhje me shkarkimin e këtyre vlerave nga magazina e Bashkisë nëpërmjet llogarisë 311 dhe mbi këtë bazë të bëhet shkarkimi i këtyre vlerave nga regjistri i aktiveve si veprim i gabuar i periudhave të mëparshme.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër në lidhje me pretendimet e paraqitura nga e Drejtorisë së Financës, Bashkia Prrenjas, janë të karakterit justifikues prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.

b. Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 703,306,598 lekë (kosto historike) është përfshirë vlera 57,966,654 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Prrenjas (në formë tabelore në programin Excel). E pa analizuar, kjo vlerë, ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Veprime këto në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

*Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Prrenjas është paraqitur observacioni nëpërmjet shkresës me Nr. 794/33 prot., datë 06.10.2025, protokolluar në KLSH me shresën nr. 403/6 prot., datë 08.10.2025 nga znj. S.K Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit dhe Planifikimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale dhe znj. B.K Përgjegjës i Kontabilitetit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:** Në lidhje me llogarinë 212(Ndërtesa e konstruksione) diferenca në vlerën 57,966,654 që rezulton në regjistrin e aktiveve është vlera e aktiveve si prona të ish- Komunave të cilat me shkrirjen e tyre si rezultat i reformës në pushtetin vendor në vitin 2015 nuk kishin dorëzuar bashkangjitur pasqyrave financiare dhe listat e aktiveve(pronave) sipas zërave me vlerat fillestare dhe vlerat neto. Për këtë arsye me miratimin e Kryetarit të Bashkisë nga Drejtoria e Financës ka dalë urdhri i brendshëm me nr. 134 datë 09.04.2025 që ne bashkëpunim me inspektoren e Aseteve pranë Drejtorisë së Urbanistikës të bëjnë verifikimin e dokumenteve në çdo arkiv të Njërive Administrative për gjetjen e vlerave të aktiveve të munguara.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër në lidhje me pretendimet e paraqitura nga e Drejtorisë së Financës, Bashkia Prrenjas, janë të karakterit justifikues prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.

### **3. Aktive afatgjata financiare.**

Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” paraqitet në vlerën 280,000 lekë.

Nga auditimi, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 1,290,000 lekë, pasi nuk është kontabilizuar vlera e aksioneve të Ujësjellës Kanalizimeve Bashkia Prrenjas e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec me Nipt. M24416601U. Nga verifikimi i bërë në QKB rezulton se vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Prrenjas është 12.9% ose 1,290,000 lekë ( $12.9 \cdot 10,000,000 / 100 = 1,290,000$  lekë). Pra duke marrë parasysh efektin me sipër llogaria 26 në datën 31.12.2024 duhet të ishte në vlerën 1,570,000 lekë ( $1,290,000 + 280,000$ ). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 280,000 lekë. Veprime këto në kundërshtim Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

#### 4. Investimet.

-Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 132,618,378 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 17,529,737,044 lekë dhe pakësim në vlerën 17,579,647,355 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 82,708,067 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”	
Gjendje në 01.01.2024	132,618,378
Shtesa	17,529,737,044
Pakësimi	17,579,647,355
Gjendja në 31.12.2024	82,708,067

Lekë

Për aktive Afatgjata materiale (kosto historike)	Gjendja 01.01.2024
Objekte inventari	
Rikonstrukcion i kanalit të lingajcës faza 2	13,164,678
Mbikëqyrje të kanalit të lingajcës faza 2	151,846
Rikonstrukcion kanalet vaditës	2,140,433
Rikonstrukcion shkolla kotodesh	20,153,190
Plan i mbar shtrimit ekonomia Sopot	3,097,920
Ndërtim shkolla e mesme Sali Halili Rrajcë	44,000,000
Totali	82,708,067

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 82,708,067 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 82,708,067 lekë, e cila nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Veprime këto në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja “ë”; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, germa “c”.

Auditim mbi administrimin e asetëve, procedurave të inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Si çdo institucion publik, edhe Bashkia Prrenjas, ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Prrenjas duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj.,.

a. Në lidhje me listat e pronave të paluajshme të Bashkisë Prrenjas dhe Njësi Administrative ka dalë urdhri i Kryetarit të Bashkisë me nr.138, datë 22.02.2024 “Ngritjen e strukturës së posaçme për përditësimin e listave të pronave shtetërore” i ndryshuar me urdhër nr. 243, datë 15.05.2024 për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer inventarizimet përkatëse në terren me qëllim plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit për hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Nga ana e këtij komisioni nuk është bërë asnjë veprim në lidhje realizimin e objektit të krijimit të tij. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që: “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Sa më sipër grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Prrenjas. Gjithashtu referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Prrenjas, në pikën 41.1.3 (specialist asetesh), në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, për inventarizimin e pronave, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar dhe më pas regjistrimin në kadastër.

b. Nga auditimi i 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje e vegla pune”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik” konstatohet se nga Bashkia Prrenjas disponohet një regjistër kontabël në formatin Excel ku përgjithësisht në të specifikohen analitikët e këtyre llogarive si dhe në të paraqitet informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia. Të meta dhe mangësi në regjistrin e aktiveve janë konstatuar në mbajtjen e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” dhe 212 “Ndërtesa e konstruksione” të cilat janë trajtuar në kapitullin përkatës. Situata e inventarit të pronave në Bashkinë Prrenjas paraqitet si vijon:

c. Në total në inventar të Bashkisë Prrenjas janë 3,797 pasuri nga të cilat janë pajisur me certifikatë pronësie 40 pasuri, të cilat paraqiten në tabelën në vijim:

Nr.	Bashkia/Njësitë	Numri i pronave në inventar	Prona të regjistruara në kadastër (me Certifikatë Pronësie)	Prona të pa Regjistruara
1	Bashkia Prrenjas	882	30	852
2	Njësia Administrative Rrajcë	908	7	901
3	Njësia Administrative Qukës	1,092	3	1,089
4	Njësia Administrative Stravaj	915	0	915
	<b>Totali</b>	<b>3,797</b>	<b>40</b>	<b>3,757</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

d. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 40 prej tyre janë të pajisura me certifikatë pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c”, për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor.

Amortizimi dhe Llogaritja e tij.

Llogaritja e amortizimit duke u bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, paraqitet në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata( vlera neto )”. Llogaritja e amortizimit dhe normat e amortizimit të përdorura për periudhën objekt auditimi janë si në tabelën në vijim.

Llog.	Emërtimi	Norma e amortizimit
202	Studime dhe kërkime	15%
213	Rruge, rrjete, vepra ujore, ndërtesa	5%
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	25%
215	Mjete transporti	20%
218	Inventar ekonomik	20%

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Nga auditimi i zbatimit të normave të amortizimit në përputhje me kuadrin rregullatorë në fuqi u konstatua se:

- Për llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” është llogaritur amortizimi jo vetëm për periudhën objekt auditimi por edhe për periudhën e mëparshme, nga kryerja e investimit e në vazhdim, për arsye se nuk është llogaritur amortizim në vitet e mëparshme.

- Llogaritja e amortizimit për aktivet jo materiale është bërë mbi vlerën e mbetur dhe jo me metodën lineare. Veprime jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II, pika 36.

3. Nen rubrika, aktive afatgjata financiare, në llogarinë 25 “Huadhënie e nën huadhënie” nuk janë kryer veprime e për rrjedhojë gjendja e sajë në pasqyrat e pozicionit financiar paraqitet në vlerën zero lekë.

## **B. PASIVET (DETYRIMET)**

### **I. Pasivet Afatshkurtra**

#### **1. Llogari të pagueshme**

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Prrenjas më datën 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.,.

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhësja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 152,568,658 lekë, 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 17,583,806 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 1,278,681 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 5,251,015 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 22,109,805 lekë ku totali shkon në vlerën 199,514,000 lekë e cila kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 199,514,000 lekë në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1.

Të dhënat për llogaritë e pagueshme në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	152,568,658	81,703,882	70,864,776
42	Detyrime ndaj personelit	17,583,806	13,953,770	3,630,036
16,17,18	Hua afat shkurtra			0
460	Huadhënës			0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,278,681	736,879	541,802
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal			0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore			0
435	Sigurime shoqërore	5,251,015	4,074,938	1,176,077
436	Sigurime shëndetësore	722,035	565,189	156,846
437,438	Organizma të tjerë shtetërore			0
44	Institucione të tjera publike			0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike			0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë			0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	38,675,760	36,630,270	2,045,490
467	Kreditorë të ndryshëm	22,109,805	22,401,738	-291,933
4341	Operacione me shtetin (detyrime)			0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)			0
<b>Gjendje në fund të periudhës</b>		<b>238,189,760</b>	<b>160,066,666</b>	<b>78,123,094</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në datë 01.01.2024, është në vlerën 81,703,882 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 320,574,901 lekë dhe pakësim në vlerën 249,710,125 lekë, ndërsa në datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 152,568,658 lekë. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelat si më poshtë:

Lekë

<b>Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”</b>	
Çelje e vitit 2024	81,703,882
Shtesa	320,574,901
Pakësime	249,710,125
<b>Gjendja debitore në 31.12.2024</b>	<b>152,568,658</b>

Analize e llogarisë me sipër

Lekë

Nr.	Objekti	Operatori ekonomik	Vlera
1	Blerje naftë	G. C shpk	4,275,732
2	Blerje benzine	G. C shpk	299,922
3	Blerje kuti dosje	A. co shpk	203,648
4	Blerje per festat 28-29-nentori	S. A.	944,400
5	Blerje kartolina	Dh. V.	54,000
6	Blerje ushqime	Mc K.	2,584,797
7	Aktivitete kulturore	J. D.	280,000
8	Sigurim punonjësish mzsh	A. jete	350,000
9	Super vizim lera uji	N. studio	110,240
10	Përmirësim i kushteve te banesave per familjare	I. shpk	7,888,842
11	Super vizim i përmirësimit te banesave	G,b civil e.	288,484
12	Hartimi i planit te mbarështimit te pyjeve	L. shpk	1,327,680
13	Super vizim punimesh rikonstruksion kanale vaditese	B. 74 shpk	15,720
14	Kolaudim punimesh rehabilitim per forcim banesah	M. c.	31,422
15	Kolaudim i rikonstruksion rrugesh brendshme	D. shpk	7,200
16	Mbikëqyrje punimesh toka te demtuara	N. studio shpk	22,612
17	Super vizim përmirësim banesash 2021	U.- studio shpk	358,117
18	Kolaudim rehabilitim terrene sportive	S. K. pf	2,664
19	Kolaudim rikonstruksion i shkollës stravaj	D. e shpk	4,550
20	Super vizim rikonstruksion rruge karkavec	R. 95 shpk	16,717
21	Kolaudim rikonstruksion rruge karkavec	K. co shpk	2,005
22	Kolaudim asfaltim rruge kotodesh	U. studio shpk	33,201
23	Kolaudim rikonstruksion rruge lagje e re Sutaj	D. e shpk	4,891
24	Mbikëqyrje ndërtim kënd lojëra lagje Bitumi	K. B. pf	23,218

Nr.	Objekti	Operatori ekonomik	Vlera
25	Mbikëqyrje ndërtim kënd lojëra lagje shkolla 9-vjecare	K. B. pf	23,220
26	Super vizim rikonstruksion rruge	N. studio shpk	22,612
27	Kolaudim rikonstruksioni i Xhelos faza 1	K. B. Pf	7,676
28	Kolaudim rikonstruksioni i Ures psarele mbi lumin Shkumbin	K. B. pf	1,259
29	Super vizim punimesh rikonstruksion rruge Muhamet Kadia	I. 18 shpk	37,149
30	Mbikëqyrje sinjalistika qyteti Prrenjas	R. 95 shpk	26,638
31	Mbikëqyrje rikonstruksion shkolla kotodesh	Z. shpk	496,547
32	Kolaudim rikonstruksion kalçeto shkolla 9-vjecare Prrenjas Fshat	P. d. 2019	5,799
33	Kolaudim rikonstruksion palestra shkolla 9-vjecare qytet	I. 18 shpk	14,514
34	Kolaudim mbrojtje rehabilitim toka te demtuara	P. d. 2019	3,392
35	Mbikëqyrje rikonstruksion kanale ujitëse	R. 95 shpk	65,984
36	Kolaudim Asfaltimi i rrugës lagje e re Toromani	R. 95 shpk	10,060
37	Mbikëqyrje ndërtim shkolla mesme Sali Halili	M. ch. shpk	1,866,177
38	Mbikëqyrje rikonstruksioni i Xhelos faza 1	Lk g. shpk	462,199
39	Mbikëqyrje rikonstruksion kanali i Lingajces faza 2	Lk g. shpk	354,846
40	Kolaudim rikonstruksion kanali i Lingajces faza 2	GSI c.	78,000
41	Kolaudim rikonstruksion kanale ujitëse	Lk g. shpk	9,898
42	Kolaudim rikonstruksion shkolla Kotodesh	2 ed shpk	65,880
43	Kolaudim përmirësim banesash viti 2023	A. H.	66,117
44	Kolaudim rikonstruksioni i kanalit xhelos faza 2	M. c. shpk	69,330
45	Mbikëqyrje punimesh fushe futbollit shkolla Arif Kuka	GSI c.	73,621
46	Kolaudim rikonstruksion i kanalit kolektor lingajce	Ne proces	9,697
47	Sinjalistika qyteti Prrenjas	R.s.& m shpk	1,562,136
48	Rikonstruksion asfaltim unaza Katjel	Ne proces	11,000,000
49	Rikonstruksion asfaltim i unazës Urake	Ne proces	11,500,000
50	Rikonstruksion dhe asfaltim i unazës fshat Prrenjas	Ne proces	16,470,359
51	Rikonstruksion dhe asfaltim i unazës lagja leka cela dhe marta	Ne proces	13,500,000
52	Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës fshatit Gurre	Ne proces	29,538,992
53	Rikonstruksion rruga bregu i Hazos	Ne proces	2,299,254
54	Blerje mjete për Dr e Shërbimeve	Ne proces	2,500,000
55	Mbrojtja dhe rehabilitimi i tokave te demtuara	Ne proces	417,224
56	Hartimi i planeve te mbarështimit te pyjeve	Ne proces	5,000,000
57	Rikonstruksion kanale vaditëse	I.shpk	409,117
58	Rikonstruksioni i shkollës kotodesh	M. shpk	5,759,316
59	Ndërtimi fushe mini futboll shkolla Arif Kuka	Oe D. shpk	2,318,580
60	Ndërtim I Shkollës Mesme Sali Halili	E. shpk	22,778,433
61	Studim Projektim Për Objektivin Rikonstruksion Unaza Katjel Urake Prrenjas Fshat Dhe Lagje Cela	Z. shpk	4,614,570
<b>Totali</b>			<b>152,568,658</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

-Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” referuar pasqyrave financiare vlera 17,583,806 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin Dhjetor të vitit 2024 e cila mbetet për t’u paguar në muajin Janar të vitit pasardhës.

Lekë

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”	
Çelje e vitit 2024	13,953,770
Shtesa	186,236,543
Pakësimi	182,606,507
Gjendja debitorë në 31.12.2024	17,583,806

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

-Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 1,278,681 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj Shtetit për muajin dhjetor.

Lekë

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”	
Çelje e vitit 2024	736,879
Shtesa	11,161,014
Pakësimi	10,619,212

Gjendja debitore në 31.12.2024	1,278,681
--------------------------------	-----------

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

-Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore dhe për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024 që paguhën në muajin Janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 5,251,015 lekë.

Lekë

<b>Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”</b>	
Çelje e vitit 2024	4,074,938
Shtesa	55,470,167
Pakësime	54,294,090
Gjendja debitore në 31.12.2024	5,251,015

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit Dhjetor të vitit 2024 që paguhën në muajin Janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerën 722,035 lekë.

Lekë

<b>Llogaria 436 “Sigurime shëndetësorë”</b>	
Çelje e vitit 2024	565,189
Shtesa	7,623,265
Pakësimi	7,466,419
Gjendja debitorë në 31.12.2024	722,035

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Prrenjas në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 38,675,760 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Librazhd. Lëvizjet e llogarisë për periudhën objekt auditimi paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

<b>Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”</b>	
Çelje e vitit 2024	36,630,270
Shtesa	9,136,639
Pakësimi	7,091,149
Gjendja debitorë në 31.12.2024	38.675,760

Në vlerën 38.675,760 lekë janë përfshirë edhe fonde të ngurtësuara për objekte që kanë përfunduar në vlerën 36,630,270 lekë. Analiza sipas subjekteve që kanë ngurtësuar fonde për objekte që kanë përfunduar paraqiten në aneksin 5 të këtij raporti auditimi.

Fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Librazhd dhe i përkasin periudhave të mëparshme të trashëguara nga ish komunat dhe në vazhdim, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit është rakorduar me Degën e Thesarit Librazhd në lidhje me vlerën e trajtuar me sipër. Nga Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 36,630,270 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Kjo ka ndodhur pasi nuk është bërë shkëmbim informacioni midis drejtorive Të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve dhe Drejtorisë së Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale në lidhje me adresën e saktë të subjekteve sipas llojit të investimit të kryer. Veprimet janë në kundërshtim me

Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

*Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Prrenjas është paraqitur observacioni nëpërmjet shkresës me Nr. 794/33 prot., datë 06.10.2025, protokolluar në KLSH me shresën nr. 403/6 prot., datë 08.10.2025 nga znj. S.K Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit dhe Planifikimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale dhe znj. B.K Përgjegjës i Kontabilitetit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:** Në lidhje me llogarinë 466 (Kreditorë për mjete në ruajtje) kemi paraqitur në bilanc listën e kuadruar me Thesarin dhe në lidhje me njoftimin e subjekteve si perfitues të këtyre vlerave mbetet për tu marrë Drejtoria e Planifikimit të Territorit sipas dosjeve të zbatimit të projekteve të investimeve që kanë në bashkëpunim me punonjësin që i ndjek kontratat në Drejtorinë e Financës.

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër në lidhje me pretendimet e paraqitura nga ana e Drejtorisë së Financës, Bashkia Prrenjas, observacionet janë të karakterit justifikues dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten detyrimet të cilat më datë 01.01.2024, janë në vlerën 22,401,738 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 50,269,381 lekë dhe pakësim në vlerën 50,561,314 lekë ndërsa në datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 22,109,805 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën në vijim:

Lekë

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2024	22,401,738
Shtesa	50,269,381
Pakësimi	50,561,314
Gjendja kreditore në 31.12.2024	22,109,805

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Lekë

C	AKTIVET NETO/FONDET (A-B)	18,848,418,604	1,604,338,156
D	FONDI I KONSOLIDUAR	18,848,418,604	1,604,338,156
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	18,504,618,709	1,450,630,388
12	Rezultatet e mbartura		
14	Grante kapitale për investime nga te trete	76,594,719	
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	267,205,176	153,707,768
111	Rezerva		
115	Nga fondet e veta të investimeve		
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime		
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme		
106	Teprica e granteve kapitale të huaja		
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim		
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata		
	Të tjera		
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	19,184,424,310	1,764,404,822

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

-Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 18,504,618,709 lekë. Analiza e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

## Lekë

Fondi i konsoliduar	Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"		
	Mbyllje më datë 31.12.2024		Çelje më datë 01.01.2024
18,848,418,604	Debi		Kredi
	4,280,413	Amortizimi i pakësim sipas pasqyrës nr. 7/b	1,450,630,388
	80,356,394	Pakësimi me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	17,449,305,980
	73,025,701	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	22,108,530
	132,618,378	Veprim i dubluar në 2023 dhe më parë, llog 231	
<b>Totali</b>	<b>290,280,886</b>		<b>18,922,044,898</b>
	18,922,044,898 - 290,280,886 = 18,631,764,012		
	18,504,618,709 - 18,631,764,012 = -127,145,303		

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 1,450,630,388 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 17,449,305,980 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 22,108,530 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 80,356,394 lekë, amortizimin shtesë në vlerën 73,025,701 lekë, sistemimet e bëra si rezultat i konstatimeve për kontabilizimet e dubluara në periudha të mëparshme në vlerën 132,618,378 lekë dhe amortizimin e pakësimit në vlerën 4,280,413 lekë për vitin ushtrimor 2024 sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)".

- Vlera e investimeve prej 132,618,378 lekë e kontabilizuar në Llog. 231, është veprim i dubluar gjatë vitit 2023 dhe në vite të mëparshme pasi janë debituar për të njëjtën shumë llogaritë:

Llog. 212 në vlerën 34,582,974 lekë.

Llog. 213 në vlerën 93,572,399 lekë.

Llog. 214 në vlerën 3,133,480 lekë.

Llog. 218 në vlerën 1,329,525 lekë.

Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" është nënvlerësuar në vlerën 127,145,303 lekë.

Nga komunikimi verbal me Përgjegjësin e Sektorit të Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Aktiveve znj. B.K, kjo diferencë vjen e mbartur për shkak dublimeve të bëra në llogarinë 231, në periudha të mëparshme, jashtë periudhës objekt auditimi. Veprime këto në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja "ë"; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 17.

## TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet", në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 84,847,087 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 83,422,978 lekë ose me një paksim në vlerën 1,424,109 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	83,422,978	84,847,087
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	37,140,724	30,072,555
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale		
7001	Tatimi mbi fitimin		
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	143,504	202,405
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	36,997,220	29,870,150
702	2. Tatimi mbi pasurinë	10,388,971	21,165,512
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	10,321,712	9,883,782
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme		
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	67,259	11,281,730
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	35,877,363	33,609,020
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Taksë mbi shërbimet specifike		
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	11,861,483	
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	24,015,880	33,609,020
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare		
7040	Taksë doganore për mallrat e importit		
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit		
7042	Tarifë shërbimi doganor e kolipostë		
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare		
705	5. Taksë e rrugës		
708	6. Të tjera tatime e taksa kombëtare	15,920	
709	7. Gjoha e kamatë vonesa		

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

## 2. Të ardhurat jo tatimore:

Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore", në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 27,542,733 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 33,994,606 lekë ose me një shtim në vlerën 6,451,873 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën në vijim:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
71	III. TË ARDHURA JO TATIMORE	33,994,606	27,542,733
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia		
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare		
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare		
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia		
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	33,994,606	27,542,733
7110	Tarifa administrative dhe rregullatorë		
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	24,401,971	19,393,414
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale		
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve		
7114	Të ardhura nga biletat		
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhëmtime	65,845	1,317,303

7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	9,526,790	6,832,016
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore		

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

### 3. Grante korente:

-Llogaria 72 “Grante korente”, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 814,046,851 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 965,486,620 lekë ose me një shtesë në vlerën 151,439,769 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
72	V. GRANTE KORENTE	965,486,620	814,046,851
720	1. Grant korent i brendshëm	965,486,620	814,046,851
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	478,177,765	447,147,058
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	269,937,902	240,022,967
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH		
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)		
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	10,601,603	9,497,788
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	199,514,000	117,077,498
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	7,255,350	301,540
7209	Të tjera grante korente të brendshme		
721	2. Grant korent i huaj		
7211	Nga Qeveri të Huaja		
	Nga Organizata Ndërkombëtare		

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

### SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 196,599,983 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 223,432,091 lekë ose me një rritje në vlerën 27,832,108 lekë.

-Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 32,689,852 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 37,344,568 lekë ose me një rritje në vlerën 4,654,716 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduar me Degën e Thesarit Librazhd me të njëjtën vlerë.

Analiza për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
6001	Paga, personel i përhershëm	223,432,091	195,817,782
602	Paga personel i përkohshëm		
603	Shpërblime		782,201
609	Shpenzime të tjera të personelit		
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	33,532,936	29,584,316
6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	3,811,632	3,105,536
	<b>Totali</b>	<b>260,776,659</b>	<b>229,289,835</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

## 2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datë 31.12.2023, ka qenë në vlerën 93,002,634 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 98,853,134 lekë ose me një rritje në vlerën 5,850,500 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduar me Degën e Thesarit Librazhd me të njëjtën vlerë.

Analiza e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën në vijim:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	98,853,134	93,002,634
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	946,560	1,166,629
6021	Materiale dhe shërbime speciale	916,200	
6022	Shërbime nga të tretë	10,947,115	16,733,454
6023	Shpenzime transporti		
6024	Shpenzime udhëtimi	1,007,170	1,079,280
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	11,871,888	15,813,820
6026	Shpenzime për qiramarrje	2,471,380	1,822,433
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale		
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua		
6029	Shpenzime të tjera operative	70,692,821	56,387,018

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

## 3. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë” paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 478,177,765 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
	V. TRANSFERIME KORENTE		
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	478,177,765	447,147,058
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendore	478,177,765	447,147,058

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Për vitin 2024 totali i të ardhurave në vlerë është 1,082,904,204 lekë dhe totali shpenzimeve është 815,699,028 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 267,205,176 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 267,205,176 lekë.

Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Nga verifikimi me zgjedhje në lidhje me sa më sipër me konstatohet se: Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat,

formularët e përlogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj., Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj., për Bashkinë Prrenjas).

-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”

Për vitin 2024 numri i punonjësve është miratuar me VKB nr. 5 datë 27.12.2023, konfirmuar ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën me nr. 68/1prot., datë 16.01.2024 i ndryshuar me VKB nr. 96 datë 08.10.2024, konfirmuar ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1144/1prot., datë 10.10.2024. Miratuar në total numri 325 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave mesatarisht 318 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.

- Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Prrenjas, është miratuar me vendim të Kryetarit të Bashkisë me nr. 10, datë 01.02.2024, ndryshuar me vendimin nr. 149, datë 29.10.2024. Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit znj. S.K dhe nga Kryetari i Bashkisë z. N.B . Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Përgjegjës Sektori i Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Aktiveve znj. B.K, nga Drejtori në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit znj. S.K dhe nga N/Kryetari i Bashkisë z. A.K; Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjësit e sektorëve, Drejtorët e Drejtorive dhe nga Nënkryetari i Bashkisë z. A.K.

Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2024. Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar 2024 dhe Dhjetor 2024) dhe konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkruara nga përgjegjësit e sektorëve, drejtorët e drejtorive nga Kryetari i Bashkisë z. N.B apo personi të cilit i është bërë delegimi i kompetencës, që është Nënkryetari i Bashkisë z. A.K. Është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Prrenjas, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “*Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH*”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Prrenjas, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë (të sipërcituar).

Sipas listë pagesave të muajve (Janar dhe Dhjetor 2024)konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve të miratuara. Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit znj. S.K dhe nga N/Kryetari i Bashkisë. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit znj. S.K dhe nga Nënkryetari i Bashkisë z. A.K. Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga përgjegjësit e sektorëve, drejtorët e drejtorive nga Kryetari i Bashkisë apo personi të cilit i është deleguar kompetenca, që është Nënkryetari i Bashkisë z. A.K. Përveç ndalesave të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi pagë, janë bërë ndalesa edhe për debitorët të përcaktuar në Urdhër përkatës(Të vendosura nga Përmbartimi apo palë të tjera). Në bazë të urdhrin nr. 302/10, datë 16.11.2023 të Zyrës Përmbartimore “Q. ShPK” është mbajtur vlera 85,000 lekë nga znj. F. K. për periudhën Janar-Maj 2024. Janë bërë ndalesa nga paga e z. N.b për periudhën Janar-Shkurt 2024 në vlerën 8,318 lekë për ç dëmtim dëmi.

Tabela e pagave sipas burimit të Financimit paraqitet në vijim;

000/lekë

Periudha	Plan	Fakt	%	Burimet e financimit			
				Transf.e pakushtëzuar	Të ardhura	Transf.e kushtëzuar	Transferte specifike
2024	267,020	218,688	81.9	109,119	7,622	97,361	4,586

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas.

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuara në këtë material ngarkohen me përgjegjësi:

- z. N.B, Kryetar i Bashkisë Prrenjas në cilësinë e nëpunësit autorizues.
- znj. S.K, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit.
- znj. B.K, me detyrë Përgjegjës Sektori i Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Aktiveve.
- z. I.G, me detyrë Përgjegjës Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore.

#### 2.4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në zbatim të programit të pikës 8 të programit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm në Bashkinë Prrenjas, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti audituar, si më poshtë vijon:

1. Shkresa përcjellëse nr.189/19, datë 25.06.2024 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë, si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës.
2. Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 20 ditë) për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit.
3. Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 6-muajsh) së bashku me raportin për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Për sa më lart në Bashkinë Prrenjas, nga grupi i auditimit u mbajt akt-verifikimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

#### *Nga auditimi u konstatua se:*

1. Bashkia Prrenjas me shkresën nr.1796/2 prot., datë 15.07.2024 ka dërguar në KLSH planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**Shkalla e zbatimit:** Ky detyrim ligjor është zbatuar.

2. Bashkia Prrenjas me shkresën nr.1796/4 prot., datë 06.12.2025 ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit prej 6-muajsh, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**Shkalla e zbatimit:** Ky detyrim ligjor është zbatuar.

#### 3. Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësive në Bashkinë Prrenjas:

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Janë dhënë **39** rekomandime, nga të cilat:

21 rekomandime organizative;

1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficecne dhe efektivitet të tyre;

1 masë për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia në vlerën 5,561 mijë lekë;

6 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, në vlerën 116,511 mijë lekë;

9 masa disiplinore ndaj 9 punonjësve;

▪ Rekomandimet e mësipërme janë pranuar plotësisht.

-Gjithashtu është dhënë edhe 1 rekomandim, por drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik, për marrjen e masave administrative ndaj anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Nga 39 rekomandime të dhëna për t'u zbatuar nga Bashkia Prrenjas, niveli i zbatimit paraqitet si më poshtë vijon:

-Për 21 rekomandime organizative janë zbatuar 8 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 8 rekomandime, janë në proces zbatimi 2 rekomandime, si dhe nuk janë zbatuar 3 rekomandime.

-Për 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienz dhe efektivitet të tyre, rezultojnë e pazbatuar;

-Për 1 masë për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia në vlerën 5,561 mijë lekë, rezultojnë e pazbatuar;

-Për 6 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, në vlerën 116,511 mijë lekë, rezultojnë se janë zbatuar pjesërisht 3 masa për vlerën 13,629 mijë lekë, si dhe nuk janë zbatuar 3 rekomandime për vlerën 22,903 mijë lekë.

Të dhënat e mësipërme janë pasqyruar në tabelën bashkëlidhur akt-verifikimit.

-Gjithashtu për 1 masë administrative drejtuar APP, rezultojnë se është zbatuar plotësisht nga APP, nga Bashkia Prrenjas është në proces.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si vijon:

## **A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1.1.Rekomandimi:** Nga Titullari i Bashkisë Prrenjas, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2024**

**Komenti Subjektit:** Për vitin 2024 është hartuar programi i trajnimit të stafit.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se për vitin 2024 është hartuar programi i trajnimit të stafit.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 është zbatuar pjesërisht.

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Përrenjas, të marrë masa për plotësimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm me numrin e nevojshëm të audituesve të certifikuar, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave.

**Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2024**

**2.2.Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Përrenjas, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart, të ndjekë me korrektësi çdo fazë të misionit auditues, duke e plotësuar me praktikën dokumentare përkatëse.

Të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit:** Është plotësuar struktura e NJAB me 3 auditues. Gjithashtu në planin e auditimeve për vitin 2025 si dhe planin strategjik të auditimeve për periudhën 2025-2027, janë planifikuar auditime për aktivitete/sisteme të vlerësuara me risk të lart.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se për vitin 2024 është plotësuar struktura e NJAB me 3 auditues. Gjithashtu në planin e auditimeve për vitin 2025 si dhe planin strategjik të auditimeve për periudhën 2025-2027, janë planifikuar auditime për aktivitete/sisteme të vlerësuara me risk të lart.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 është zbatuar

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.2 është zbatuar

**3.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Përrenjas, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.470 “Të ardhura për t’u marrë”.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2024**

**Komenti Subjektit:** Janë marrë masat e nevojshme me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se është kryer kontabilizimi.

**Zbatimi:** Rekomandimi 3.1 është zbatuar

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Përrenjas, të marrë masat për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”. Veprimet e sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2024**

**Komenti Subjektit:** Janë marrë masat e nevojshme me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se është kryer kontabilizimi.

**Zbatimi:** Rekomandimi 4.1 është zbatuar

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Përrenjas, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Në përfundim të merren masa për raportimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2024**

**Komenti Subjektit:** Janë marrë masat e nevojshme me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se është kryer kontabilizimi.

**Zbatimi:** Rekomandimi 5.1 është zbatuar

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria financës në Bashkinë Përrenjas të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktiviteti afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivitetet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2024**

**Komenti Subjektit:** Janë marrë masat e nevojshme me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se nuk është kryer kontabilizimi.

**Zbatimi:** Rekomandimi 6.1 nuk është zbatuar

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Përrenjas, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2024**

**Komenti Subjektit:** Janë marrë masat e nevojshme me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se është kryer kontabilizimi.

**Zbatimi:** Rekomandimi 7.1 është zbatuar

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Përrenjas në bashkëpunim me Drejtorin e Planifikimit të Territorit, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i’u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2024**

**Komenti Subjektit:** Janë marrë masat e nevojshme me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se nuk janë marrë masa.

**Zbatimi:** Rekomandimi 8.1 **nuk është zbatuar**

**9.1. Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Përrenjas), të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit:** Është marrë në konsideratë rekomandimi dhe është zbatuar.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit përkatës, konkretisht procedurat e prokurimit, rezulton se jo në të gjitha rastet zyrtarët e procesit të prokurimit janë specialist të fushës, trajtuar më hollësisht në akt-konstatimin e mbajtur për pikën 4 të programit të auditimit.

**Zbatimi:** Rekomandimi 9.1 **është zbatuar pjesërisht**

**10.1.Rekomandim:** Bashkia Përrenjas të marrë masa që për procedura të ndara me faza, me objekt hartimin e planeve të mbarështimit, vlerësimi i fazës së parë kualifikuese të jetë i tillë që të mundësojë konkurrimin e shumë operatorëve ekonomikë në fazën e dytë, duke i konsideruar urdhrat e ministrit për miratimin e planeve të mbarështimit si vërtetime që provojnë kryerjen e shërbimeve të ngjashme.

**Në vijimësi**

**Komenti Subjektit:** Është marrë në konsideratë rekomandimi dhe është zbatuar.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se përgjatë vitit 2024 nuk është kryer procedurë me objektin e mësipërm.

**Zbatimi:** Rekomandimi 10.1 **nuk është zbatuar**

**11.1.Rekomandimi:** Bashkia Përrenjas të marrë masa që në punimet për rikonstruksione të rrugëve të përfshijë zërat për asfaltim dhe punime të tjera, me qëllim realizimin e investimeve në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme si dhe të argumentojë përmes një relacioni teknik arsyet e ndryshimeve të zërave të punimeve për procedura me objekt të ngjashëm prokurimi.

**Në vijimësi**

**Komenti Subjektit:** Bashkia Përrenjas ka marrë masa që në detyrat e projektimit të hartuar për objekte të tipologjisë rruge ka kërkuar që në hartimin e projekt-preventivave ku të përfshihen zera për asfaltim rrugësh dhe punimesh të tjera, si rikonstruksioni dhe asfaltimi i unazës së fshatit Katjel, fshatit Urakë, etj.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se procedurat studim projektim për rikonstruksionin dhe asfaltimin e disa rrugëve, por edhe në procedurat me objekt punime rikonstruksioni dhe asfaltimi, rezulton se janë përfshirë zërat e mësipërm.

**Zbatimi:** Rekomandimi 11.1 **është zbatuar**

**12.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikim, Kontroll Zhvillim Territorit Bashkia Përrenjas, në dhënien e lejeve të ndërtimit/zhvillimit të ketë konsideratë :

- T'u kërkojë subjekteve përkatëse përcjelljen e një deklaratë noteriale për shprehjen e pëlqimit nga bashkëpronarët, duke refuzuar dhënien e certifikatës së përdorimit deri në plotësimin e dokumentacionit.

- Në miratimin e lejeve të ndërtimit të respektojë lartësitë e kateve të përcaktuara për njësitë strukturore sipas Planit të Përgjithshëm Vendor.

- Në rubrikën e kushteve të lejeve, në rastet kur ndërtimi i ri kërkon prishjen e objektit të vjetër, të përcaktojë që njoftimi i fillimit të punimeve të shoqërohet me aktin teknik të shembjes së objektit. Për leje ndërtimi të llojit shtesa në objekt ekzistues, sipas rastit, të kërkojë si dokumentacion aktin e ekspertizës për të argumentuar qëndrueshmërinë e objektit të ri.

#### **Në vijimësi**

**Komenti Subjektit:** Drejtoria e Planifikim, Kontrollit, dhe Zhvillimit të Territorit, ka marrë në konsideratë për kërkimin e deklaratave noteriale për shprehjen e pëlqimit nga bashkëpronarët dhe dhënien e lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet kur dokumenti i pronësisë ka qënë me bashkëpronarë. Ndërsa për subjektet e cituar në raportin përfundimtar të auditimit, këto subjekte akoma nuk kanë aplikuar për certifikatë përdorimi që tju kërkohet plotësimi i dokumentacionit. Për vitin 2024 nuk ka shumë kërkesa për aplikim për leje zhvillim/ndërtim, për ato aplikime të cilat janë shqyrtuar i'u është kërkuar respektimi i lartësisë (në metra), konformë Planit të Përgjithshëm Vendor.

Ndërsa përsa i përket subjekteve të tipologjisë “Prishje objekti ekzistues dhe rindërtim” apo “Ndërtim shtesash në objekte eksiztuuese”, nuk ka patur aplikime për këto tipologji objektesh.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit përkatës, konkretisht procedurat e dhënieve të lejeve të ndërtimit rezulton se është kërkuar deklarata noteriale e bashkëpronarëve, trajtuar më hollësisht në akt-konstatimin e mbajtur për pikën 6 të programit të auditimit.

**Zbatimi:** Rekomandimi 12.1 është në proces

**13.1.Rekomandimi:** Bashkia Përrenjas të marrë masa për të verifikuar në terren shtrirjen e tubacioneve, sipas planvendosjes së lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin nr. 5 datë 05.05.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe të plotësojë dosjen me dokumentacionin e lejes përkatëse të ndërtimit.

#### **Menjëherë**

**Komenti Subjektit:** Është plotësuar dosja e subjektit. Nga dokumentacioni që disponojmë rezulton se Subjekti G. shpk, në vitin 2017 ka bërë ndryshimet e planvendosjes së gjurmës së Hec-ve.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se është plotësuar dosja e subjektit për lejen e ndërtimit.

**Zbatimi:** Rekomandimi 13.1 është zbatuar

**14.1.Rekomandimi:** Bashkia Përrenjas të marrë masa për ngritjen e një strukture të posaçme për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në funksion të përditësimit të inventarit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme, përmes verifikimit juridik dhe faktik (evidentim në terren) të gjendjes së pronave. Në veçanti, të përcaktojë si prioritet regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shërbimeve arsimore, si shkolla, kopshte dhe çerdhe.

#### **Menjëherë**

**Komenti Subjektit:** Bashkia Përrenjas me urdhërin nr. 43, datë, 15.05.2024 “Për ngritjen e strukturës së posaçme për përditësimin e listave shtetërore”, ka ngritur strukturën për

inventarizimin, përditësimin dhe ndjekjen e gjithë procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin kadastral publik dhe pajisjen me certifikat pronësie.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se me urdhërin nr. 243, datë, 15.05.2024 “Për ngritjen e strukture të posaçme për përditësimin e listave shtetërore”, është ngritur struktura e posaçme për inventarizimin, përditësimin dhe ndjekjen e gjithë procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin kadastral publik dhe pajisjen me certifikat pronësie, por nga ky grup pune nuk dokumentohen masat e marra në zbatim të urdhrorit të mësipërm.

**Zbatimi:** Rekomandimi 14.1 është zbatuar pjesërisht

**15.1.Rekomandimi:** Bashkia Përrenjas të marrë masa që të parashikojë fonde për miratimin e planeve të mbarështimit për ekonomitë pyjore, regjistrimin e sipërfaqeve pyjore si dhe për plotësimin e numrit të inspektorëve në pyje në raport me sipërfaqet në hektarë që i janë transferuar.

**Në vijimësi**

**Komenti Subjektit:** Aktualisht është hartuar plani i mbarështimit për ekonominë pyjore Sopot, i cili është miratuar paraprakisht në Këshillin Bashkiak Përrenjas. Për vitin 2025 kemi parashikuar në Buxhetin e Bashkisë që të vazhdojmë me hartimin e planeve të tjera të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave. Përsa i përket regjistrimit të pronave, janë regjistruar vetëm disa nr. pronash që janë dhënë në përdorim me kontrat qiraje.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se për vitin 2024 është planifikuar fond për investime në programin ekonomik 04260. Nuk rezulton që të ketë pësuar ndryshime struktura e sektorit të pyjeve, pra rritjen e numrit të punonjësve.

**Zbatimi:** Rekomandimi 15.1 është zbatuar pjesërisht

**16.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Përrenjas dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe të bëjë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

**16.2.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

**Përgjatë vitit buxhetor 2024 dhe në vijim**

**Komenti Subjektit:** Rekomandimet e mësipërme janë pranuar nga subjekti i audituar.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se për vitin 2024 janë planifikuar për likuidim detyrimet e prapambetura, por nuk është hartuar grafiku i likuidimit. Lidhur me planifikimin realist të të ardhurave të veta, si burim për buxhetin e vitit 2024, nga shqyrtimi i buxhetit të miratuar për vitin 2024, rezulton se të ardhurat e planifikuara që do të arkëtohen përgjatë këtij viti janë 135,700 mijë lekë, ndërkohë nëse i referohemi realizimit faktik të të ardhurave për vitin 2022 dhe 2023, rezulton në vlerat 94,054 mijë lekë për vitin 2022 dhe 94,646 mijë lekë për vitin 2023, pra me një diferencë nga plani i vitit 2024, vlerë e cila është brenda intervalit 41,054 mijë lekë deri në 41,644

mijë lekë, mos realizim. Pra kuptohet qartë se plani i të ardhurave për t'u mbledhur gjatë vitit 2024, nuk bazohet në historikun e të ardhurave faktike të realizuara në vitet e mëparshme, ç'ka e bënë një planifikim jo realist.

**Zbatimi:** Rekomandimi 16.1 është zbatuar pjesërisht

**Zbatimi:** Rekomandimi 16.2 nuk është zbatuar

**17.1. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Përrenjas, të vijojë procedurën për nxjerrjen e Vendimit për “Prishje Objekti të Kundërligjshëm”, që janë me procesverbal konstatimi për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi dhe të nxjerrë “Urdhër Ekzekutimi” për prishjen e objekteve të kundërligjshëm për subjekte që janë me Vendim për “Prishje Objekti të Kundërligjshëm”.

**17.2. Rekomandimi:** Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Përrenjas, të marrë masa si vijon:

-Mbajtjen e aktkontrolleve për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

-Moslejimin e zhvillimit të ndërtimit në kushtet e mungesës së lejes së zhvillimit dhe të ndërtimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

-Në çdo rast që konstatohet shmangie nga projekti i miratuar, përveç ndëshkimit me masë administrative, heqjen e licencës profesionale për personat përgjegjës, sipas parashikimeve ligjore, me qëllim forcimin e masave për kontrollin e territorit dhe mbrojtjen e tij nga ndërhyrjet abuzive.

-Rritjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Politikave Urbane, për shkëmbimin e informacionit midis tyre. Realizimin e kontrolleve periodike mbi objektet në zhvillim, të pajisur me leje ndërtimi, për të verifikuar nëse zbatimi i punimeve kryhet sipas projektit të miratuar.

-Përgatitjen e planeve vjetore dhe mujore të punës dhe informacionin periodik tre mujor ndaj Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) mbi aktivitetin e saj, procedurat e mbajtura gjatë kësaj kohe dhe vendimet e marra.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit:** Janë marrë masa duke nxjerrë vendimet e gjobave për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje ose në shkelje të lejes.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se nuk është zbatuar, trajtuar më hollësisht në akt-konstatimin e mbajtur për pikën 7 të Programit të Auditimit.

**Zbatimi:** Rekomandimi 17.1 është zbatuar pjesërisht

**Zbatimi:** Rekomandimi 17.2 është zbatuar pjesërisht

## **A.2. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.**

**18.1. Rekomandim:** Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Përrenjas, të marrë masa për plotësimin e Njesisë së auditimit të brendshëm me 3 auditues, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, VKM-ve dhe Manualeve, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave.

**3.1. Rekomandimi:** Nga Nëpunësi zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrave të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: data e hyrjes ose e marrjes në dorëzim. Përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mrëmbajtjes, data e daljes nga pronësia.

**8.1 Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMTV Bashkia Përrenjas, të marrë masa që në të ardhmen, të nxjerrë vendimet e gjobave për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje ose në shkelje të lejes, të kryet pezullimi i punimeve në aktin përkatës si dhe të nxirren vendimet për prishjen e tyre.

**Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)**

**1.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Përrenjas dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për arkëtimin e detyrimeve të palikujduara nga debitorët progresivë për vitin 2022, nga mospagesa e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara në paketën fiskale nga subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi si dhe nga subjektet familjare në vlerën totale 63,391,576 lekë.

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Urbanistikës të përcjellë listën me subjektet debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë si dhe në vijim Bashkia Përrenjas të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 2,526,900 lekë.

**6.1 Rekomandimi:** Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës, personit të ngarkuar për llogaritjen e TNI për objektet e reja që kanë tipologjinë e mësipërme, taksa të përlllogaritet bazuar në çmimin e shitjes.

**6.2 Rekomandimi:** Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e Taksave Tarifave Vendore të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej 10,047,964 lekë ndaj 2 subjekteve për llogaritje të gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga të cilat 4,170,770 lekë për subjektin L. B. dhe E. B. si dhe 5,877,194 lekë për subjektin M–P.

### **Menjëherë**

**Komenti Subjektit:** Bashkia Përrenjas ka marrë masa për plotësimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, struktura është plotësuar me 3 punonjës.

Janë marrë masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrave të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: data e hyrjes ose e marrjes në dorëzim. Përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mrëmbajtjes, data e daljes nga pronësia.

Janë marrë masa duke nxjerrë vendimet e gjobave për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje ose në shkelje të lejes, të kryet pezullimi i punimeve në aktin përkatës si dhe të nxirren vendimet për prishjen e tyre.

Subjekti M. – P ka arkëtuar vlerën e plotë prej 5,877,194 lekë në Bashkinë Përrenjas. Për subjektin e z. L.B dhe znj. E.B është lidhur kontratë me nr. 650 prot, datë 07.10.2024 dhe është arkëtuar vetëm kësti i parë referuar marrëveshjes.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se është plotësuar struktura e NJAB, janë hartuar regjistrat e aktiveve, si dhe është likujduar vlera 5,877,194 lekë.

**Zbatimi:** Rekomandimi 18.1 është zbatuar pjesërisht.

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE.**

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Përrenjas të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

**Përgjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2024 dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit:** Bashkia Përrenjas ka ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për proceset gjyqësore. Përsa i përket procedurave, nga ana e Bashkisë Përrenjas përgjithësisht janë ndjekur procedurat për zgjidhjen e marrdhënieve të punës, gjykatat nuk i kanë marrë në konsideratë rishikimet që ka bërë bashkia apo dhe procedurat e ndjekura për ndërprerjen e marrdhënieve të punës dhe përsëri gjykata nuk e kanë cilësuar si shkak për largimet nga puna.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, nuk rezulton që të jetë kryer analizë dhe të jetë dokumentuar nëpërmjet relacionit drejtuar titullarit të Bashkisë Përrenjas, për arsyet e largimeve nga puna.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 **nuk është zbatuar**

## **C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.**

**1.1.Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Përrenjas, Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave, dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve kontraktuale në vlerën **2,729,835 lekë**, si dhe kamatëvonesa deri më 31.12.2023 në vlerën **2,831,729 lekë**.

**Brenda datës 31.12.2024**

**Komenti Subjektit:** Rekomandimi është pranuar pjesërisht.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Për zbatimin e rekomandimit të mësipërm nuk u vendos dokumentacion në dispozicion të Grupit të Auditimit.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 **nuk është zbatuar**

## **D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.**

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **2,037,791 lekë**.

**Menjëherë**

**Komenti Subjektit:** Rekomandimi është pranuar. Janë dërgur njoftimet me shkresa zyrtare për qytetarët/subjekte datë 29.07.2024 prot. 2031 duke i vënë në dijeni për detyrimin e taksës së

ndikimit në infrastrukturë dhe marrjen e masave për shlyrjen e detyrimeve ndaj Bashkisë Përrenjas. Vlera debitore deri më datë 31.12.2023 është 2,037,791 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 239,641 lekë.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se shkresa e cituar, nuk i drejtohet asnjë personi fizik/juridik mbi detyrimet e përlogaritura për TNI, për legalizimin e ndërtimeve informale. Pagesat e kryera i referohen njoftimeve të mëparshme dhe shkresës së sipërcituar. Gjithashtu nuk rezultojnë masa të marra në mënyrë shteruese për arkëtimin e detyrimit të mësipërm.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 **nuk është zbatuar**

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave dhe Licensave, në bashkëpunim Njësitë Administrative të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, duke verifikuar në terren si dhe marrjen zyrtare e të dhënave nga institucionet përkatëse. Pas identifikimit dhe evidentimit me të gjithë treguesit të parcelave të tokës që disponon çdo fermer, të rishikohet planifikimi i të ardhurave për këtë taksë, të ndiqet arkëtimi i saj nëpërmjet njoftim-vlerësimeve për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermerë dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative e ligjore në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit. Gjithashtu të ndiqen të gjitha rrugët ligjore deri në arkëtimin e vlerës 16,865,439 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Përrenjas.

**Menjëherë**

**Komenti Subjektit:** Rekomandimi është pranuar. Janë ngritur grupet e punës në çdo njësi administrative dhe në Bashkinë Përrenjas për sistemimin e sipërfaqes bujqësore, puna ngelet progresive dhe e vazhdueshme.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, nuk dokumentohen veprime të kryera për zbatimin e rekomandimit të mësipërm.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 **nuk është zbatuar**

**3.1.Rekomandimi:** IMTV dhe Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave në Bashkisë Përrenjas të ndjekin të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **4,000,000 lekë**.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit:** Rekomandimi është pranuar.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Për rekomandimin e mësipërm nuk është vendosur dokumentacion në dispozicion të Grupit të Auditimit.

**Zbatimi:** Rekomandimi 3.1 **nuk është zbatuar**

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave Bashkia Përrenjas në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Përrenjas, si, Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Drejtorinë Juridike, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Financës, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **87,518,388 lekë** kjo për subjekte/abonent familjare, për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

**Menjëherë**

**Komenti Subjektit:** Rekomandimi është pranuar. Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave janë marrë masat për arkëtimin e detyrimeve për subjektet/abonent familjare duke dërguar kërkesë për shlyerje detyrimesh, shkresa nr.260 prot., datë 05.02.2024. Për 136 subjekte biznes i vogël në Qytetin Prrenjas, janë likuajduar 2,291,095 lekë. Për 43 subjekte biznes i vogël në NJA Rrajcë janë likuajduar 424,923 lekë. Për 29 subjekte biznes i vogël në NJA Qukës janë likuajduar 340,107 lekë. Për biznesin e madh janë arkëtuar 4,610,633 lekë.

Pra në total janë arkëtuar 7,666,758 lekë.

Gjithashtu janë likuajduar 5,181,327 lekë nga abonentët familjarë.

Pra likujdime në total janë në vlerën 12,848,085 lekë.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nuk janë marrë masat në mënyrë shteruese për arkëtimin e detyrimeve, ndaj subjekteve të cilat nuk kanë paguar vullnetarisht, apo edhe pas bllokimit të llogarive bankare. Rekomandimi është në proces zbatimi.

**Zbatimi:** Rekomandimi 4.1 është zbatuar pjesërisht

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve bashkia Përrenjas, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **1,600,000** lekë nga 2 subjektet, respektivisht;

-Vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “L.” SHPK.

-Vlera 600,000 lekë nga subjekti “K.” SHPK.

**Menjëherë**

**Komenti Subjektit:** Rekomandimi është pranuar. Subjekti K. shpk ka bërë një pagesë prej 200,000 lekë datë 02.07.2024.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se është kryer pagesa prej 200,000 lekë nga K.

**Zbatimi:** Rekomandimi 5.1 është zbatuar pjesërisht

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Përrenjas, të marrë të gjitha masat duke zbatuar të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për nxjerrjen dhe kontabilizimin e detyrimeve për tarifën e “Mjedisit” dhe tarifën e “Pastrimit” për 25 subjektet në vlerën **4,490,000 lekë**, respektivisht:

-Vlera 700,000 lekë për 2 subjekte HEC.

-Vlera 2,250,000 lekë për 9 subjekte me lloj aktiviteti si, karrierë guri, inerte etj.

-Vlera 1,540,000 për 14 subjekte me veprimtari Hec, Gurore, Minierat dhe Nyje betoni etj.

**6.2.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Përrenjas të ushtrojë kontrolle pranë aktiviteteve të subjekteve të cituar më sipër, me qëllim identifikimin nëse, ushtrohet ose jo veprimtaria prej tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit:** Rekomandimi është pranuar pjesërisht. Subjektet janë tarifuar me tarifën “Për Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Mjedisit” dhe tarifën e pastrimit. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore ka ushtuar verifikime në terren dhe është në vijimësi. Për pikën “Mostarifikim për tarifën e Mbrojtjes dhe Përmirësimin e Mjedisit ju bëjmë me dije se: Subjekti K. me nipt K.....C dhe subjekti L me nipt J.....M janë tarifuar me Tarifën “Për Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Mjedisit”, subjekti F me nipt L.....Q është i pezulluar si aktivitet prandaj nuk është tarifuar për vitin 2023. Subjekti Deutsche Energjie me nipt L.....O ka zyrtar qëndrorë në Bashkinë Prrenjas dhe aktivitetin (Import Eksport, Projektim) e kryen në Tiranë. Subjekti E me nipt L.....I ka magazinimin e materialeve të ndryshme dhe jo shfrytëzim karrierash në Bashkinë Prrenjas.

Subjektet A. dhe B. X kanë paguar detyrimin.

Subjektet me aktivitet HEC: Subjekti B. 2017 me Nipt L...K ka lidhur kontratë qiraje me fond pyjor por nuk ka filluar akoma aktivitet dhe nuk ka hapur adresë për ushtrim aktiviteti në territorin e Bashkisë Prrenjas.

Për sa i përket Tarifës së Pastrimit subjekti “E” Hec i cili ka lidhur kontratë qiraje me nr. 782 prot., datë 09.04.2021 me vlerë vjetore 1,114,110 lekë, nuk ka kryer aktivitet akoma në territorin e bashkisë Prrenjas dhe për këtë arsye nuk është tarifuar me Tarifën e Pastrimit. Gjithashtu subjektet B. 2017 dhe E. nuk kanë hapur akoma adresë për ushtrim aktiviteti në bashkinë Prrenjas por vetëm kanë lidhur kontratë qiraje. Për subjektin S & Amp; D shpk cili ka lidhur kontratë me nr. 3091 prot., datë 15/11/2021 për “Shfrytëzimin e Lëndës Drusore në Këmbë” me vlerë 1,790,820 lekë ka kryer pagesën për këstin e parë në vlerën 895,410 lekë me datë 15.11.2021, dhe kësti i dytë në vlerën 895,410 lekë është paguar në datë 14.07.2022.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezultojnë se janë kryer pagesa në vlerën 500,000 lekë. Subjekti E ka kryer likujdime në vlerën 81,728 lekë.

**Zbatimi:** Rekomandimi 6.1 është zbatuar pjesërisht

#### **E. MASA DISIPLINORE.**

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil: Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Prrenjas**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

#### **“Vërejtje” në zbatim të pikës “a” të nenit 58, për 9 punonjës;**

1. Znj. M.P, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Aplikimit të Projekteve, për mangësi në dokumentacionin ligjor dhe mosrespektimin e lartësive maksimale të kateve, veprime në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Prrenjas, si dhe në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për 7 raste (procedura prokurimi) ka aplikuar kriteret të paargumentuara, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
2. Znj. Z.C, me detyrë Drejtore Juridike, Prokurimeve Publike dhe Burimeve Njerëzore, për mangësi në realizimin e procedurave me blerje të vogël, veprime në kundërshtim me pikën 5 të udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, si dhe në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për 10 raste (procedura prokurimi) ka aplikuar kriteret të paargumentuara, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
3. Znj. M.R, me detyrë përgjegjëse sektori, sektori juridik dhe prokurimeve, për mangësi në realizimin e procedurave me blerje të vogël, në cilësinë e anëtares së komisionit të blerjeve të vogla, veprime në kundërshtim me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, si dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për 5 raste (procedura prokurimi) ka shpallur fitues OE të cilët nuk janë në kushtet plotësimi të të

gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82.

4. Z. L. L, me detyrë Drejtor i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, për mangësi në vlerësimin e procedurës “shërbim konsulence” me objekt “Për hartimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Sopot”, në cilësinë e Kryetarit të KVO, veprime në kundërshtim me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

5. Znj.A K, me detyrë specialiste, për mangësi në realizimin e procedurave me blerje të vogël, në cilësinë e anëtares së komisionit të blerjeve të vogla, veprime në kundërshtim me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, si dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për 4 raste (procedura prokurimi) ka shpallur fitues OE të cilët nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82.

6. Znj. R. D, me detyrë specialiste, për mangësi në realizimin e procedurave me blerje të vogël, në cilësinë e anëtares së komisionit të blerjeve të vogla, veprime në kundërshtim me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, si dhe në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për 10 raste (procedura prokurimi) ka aplikuar kriterëve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë me tipologjinë e procedurës, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

7. Znj. M.H, me detyrë specialiste, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për 6 raste (procedura prokurimi) ka shpallur fitues OE të cilët nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82.

8. Znj. M. V, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për 2 raste (procedura prokurimi) ka shpallur fitues OE të cilët nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82.

9. Z. A.O, me detyrë specialist në Drejtorinë e të Ardhurave, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për 1 rast (procedura prokurimi) ka shpallur fitues OE të cilët nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82.

**Komenti Subjektit:** Rekomandimi është pranuar. Janë dhënë masa disiplinore përkatëse dhe disa janë në proces.

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se nga Kryetari i Bashkisë Prrenjas janë vendosur masat disiplinore “vërejtje” ndaj punonjësve L.L dhe A. O.

**Zbatimi:** Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

## **G. PËR MASA ADMINISTRATIVE**

### **G.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me nenet 3- “Parimet e përzgjedhjeje”, 98- “Anulimi i një procedure”, 76- “Kriteret detyruese për skualifikim”, 92- “Shqyrtimi i ofertave” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 41 – “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, 67- “Klasifikimi i ofertave”, 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, 82- “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, 83-

“Njoftimi i fituesit”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; nenin 132 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për:

**a- Anëtarët e Hartimit të specifikimeve teknike dhe Njësisë së Prokurimit**, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 –“Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, 78-“Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**b- Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave**, në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 3- “Parimet e përzgjedhjeje”, 9-“Anulimi i një procedure”, 76- “Kriteret detyruese për skualifikim”, 92- “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 67- “Klasifikimi i ofertave”, 82- “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, 83- “Njoftimi i fituesit”. (Trajtuar në pikën 4 faqe 76-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Komenti Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm, rezulton se APP ka marrë vendimin nr.14, datë 07.03.2025, sipas të cilit është vendosur:

- Gjobë në vlerën 20,000 lekë ndaj M.V.
- Gjobë në vlerën 30,000 lekë ndaj RD.
- Gjobë në vlerën 60,000 lekë ndaj A.K.
- Gjobë në vlerën 70,000 lekë ndaj M R.
- Gjobë në vlerën 30,000 lekë ndaj L.K.
- Gjobë në vlerën 50,000 lekë ndaj M.P.
- Gjobë në vlerën 50,000 lekë ndaj M.H.

Vendosjen e masës disiplinore ndaj R.B, L.L, Xh.Xh, N.G, M.K, A.O, E. B, M.Z, L.K. dhe M.M Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se nga Kryetari i Bashkisë Prrenjas janë vendosur masat disiplinore “vërejtje” ndaj punonjësve L.K, M. M, M. K, E. B, M. Z, L.L, Xh. Xh, A. O. Në zbatim të vendimit të APP, me shkresën nr.940 prot., datë 02.05.2025 janë njoftuar punonjësit e mësipërm për likuidimin e gjobave të vendosura.

## **2.5. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit.**

Gjatë auditimit nuk ka pasur çështje të tjera, veç çështjeve të programit të trajtuara më sipër.

### **IV. REKOMANDIME**

#### **A.MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimit:** Nga auditimi lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, grupi i auditimit bazuar në informacionin e grumbulluar nga pyetësorët mbi vetëvlerësimin dhe rezultatet e testimeve të kryera ka konstatuar se, komponentët e MFK-së nuk kanë funksionuar plotësisht dhe me efektivitet, në të gjithë strukturat e njësisë, pavarësisht përpjekjeve të këtij institucioni për të shkuar drejt konsolidimit. Më konkretisht u konstatua se në “Rregulloren e Brendshme” nuk janë të përcaktuara të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë mbi organizimin e veprimtarisë së institucionit sipas strukturës organizative të miratuar. Për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës bazuar në “Kodin e Punës”, nuk janë të përcaktuara mënyra apo kriteret e rekrutimit/largimit për çdo pozicion pune. Për largimet nga puna nuk është zbatuar VKM nr. 124, datë 17.02.2016, neni 29, ku me Proces Verbal të dorëzohen inventari në ngarkim i pajisjeve në njësinë përgjegjëse.

- Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dizpozicion u konstatua se Bashkia Prrrenjas nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj riskut për mashtrime, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar. Bashkia Prrrenjas ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni.,

-Nga auditimi i dokumentacionit që ka të bëjë me shkresat e përpiluara midis strukturave të Bashkisë konstatohet se, rakordimet për debitorët janë bërë me shkresa të pa protokolluara në zyrën e protokoll arkivës, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, neni 22. Rakordimet midis strukturave të Bashkisë në lidhje me debitorët nuk janë bërë në përputhje me nenet 11-20 të “Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

-Regjistrimet kontabël në Bashkinë Prrrenjas nuk mbahen në programe financiare por në Excel.. Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me: Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016; ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, germa “b”; Ligjin nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, neni 13; VKM nr. 117/2014, i ndryshuar me VKM nr. 833, datë 28.10.2020, Kreu nr. 1, pika nr. 1; VKM nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, pika 2.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**1.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për analizimin e mangësive, si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm konkretisht:

-të kryej vlerësime periodike të ekspozimit ndaj riskut për mashtrime.

-të përcaktoj në “Rregulloren e Brendshme” detyrat dhe përgjegjësitë mbi organizimin e veprimtarisë së institucionit.

### *Menjëherë e në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi lidhur me veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm për vitin 01.01.2024-31.12.2024 u konstatua se, kjo njësi nuk ka kryer trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 për “*Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit*” i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut. Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Prrenjas nuk ka hartuar “Programin e veçantë për sigurimin e brendshëm të cilësisë të njesisë së auditimit të brendshëm dhe nuk ka përcaktuar indikatorët e matjes dhe vlerësimit të performancës së veprimtarisë audituese” në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VII. Njëkohësisht nuk janë dhënë rekomandime për përmirësimin e punës audituese aty ku janë vërejtur mangësi e difekte në zbatimin e standardeve të auditimit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 24-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1.Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm të marrë masa që të:

- Planifikojë dhe kryej trajnime për punonjësit në lidhje me auditimet që paraqesin risk të lartë;
- Të hartojë programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të njesisë së auditimit të brendshëm, ku të përcaktojë indikatorët e matjes dhe vlerësimit të performancës së veprimtarisë audituese.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i taksave dhe i tarifave vendore u konstatua se, nuk është kryer një planifikim i saktë i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, ku për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta (si të ardhurat nga tarifave e ujit të pijshëm në 6 %) nga 14,000,000 lekë planifikuar, janë realizuar vetëm 862,780 lekë dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin deri në 336% (taksa e kalimit të drejtës së pronës) nga 20,000 lekë e planifikuar, janë realizuar 67,259 lekë. Kjo gjë tregon se planifikimi i të ardhurave nuk bëhet bazuar në të dhëna dhe analiza reale, kjo vjen për shkak të mos planifikimit mbështetur në të dhëna reale dhe mos marrjen e të gjitha masave të nevojshme për arketimin e të ardhurave, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.68/2017 “*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*”, neni 5, gërma (a). (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1 Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të kryejë planifikime reale bazuar në analiza të hollësishtme për secilin zë. Të marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm dhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifave vendore nga vitet paraardhëse, me qëllim që planifikimi dhe realizimi i buxhetit të jetë sa më i saktë.

### *Në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” janë përfshirë projekte në vlerën 9,622,240 lekë (kosto historike), të cilat nuk janë kontabilizuar drejt, pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e investimit. Këto veprime janë në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja “ë”; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin

e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe .44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria financës në Bashkinë Prrenjas të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

#### *Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2025*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se, kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 1,290,000 lekë, pasi nuk është kontabilizuar vlera e aksioneve të Ujësjetës Kanalizimeve Bashkia Prrenjas e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetës Kanalizime Pogradec me Nipt M24416601U. Sipas të dhënave të QKB-së rezultoi se vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Prrenjas është 12.9% ose 1,290,000 lekë ( $12.9 \cdot 10,000,000 / 100 = 1,290,000$  lekë). Këto veprime janë në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja “ë”; VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimin dhe përpunimin të ujërave të ndotura”; Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu 3.1, pika 31, 125 shkronja “b”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Prrenjas, të marrë masat e nevojshme, që të saktësojë regjistrimet kontabël duke debituar llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredituar llogarinë 1011, “Shtesa të fondit bazë”.

#### *Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2025*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Prrenjas, në fund të vitit 2024 ka në përbërje të saj fonde në vlerën 36,630,270 lekë, të cilat përfaqësojnë vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit. Nga Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve pasi nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 36,630,270 lekë. Kjo ka ndodhur pasi nuk është bërë shkëmbim informacioni midis drejtorive të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve dhe Drejtorisë së Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale në lidhje me adresën e saktë të subjekteve sipas llojit të investimit të kryer. Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja “ë”; Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve, të marrin masat e nevojshme për saktësimin e adresave të subjekteve që u ka kaluar afati për vlerën e garancisë së kontratave, të kryhen njoftimet përkatëse në mënyrë që të bëhet i mundur zhbllokimi i fondeve, gjendje në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” dhe ne rast të mos reagimit të subjekteve të shihet mundësia që këto fonde të përdoren për interes publik.

#### *Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2025*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se në gjendjen e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” është përfshirë vlera 6,969,028 lekë (kosto historike) e cila është e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga vitet e mëparshme.

Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 703,306,598 lekë (kosto historike) është përfshirë vlera 57,966,654 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga vitet e mëparshme nga bilanci i ish-komunave.

Këto aktive të pa analizuar ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit.

Veprime këto në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja “ë”; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III, pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Prrenjas të marrë masa për ngritjen e grupit të inventarizimit, i cili në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Menaxhimin Financiar dhe Shërbimeve Sociale, të saktësojnë në mënyrë të detajuar në sasi dhe vlerë llogarinë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”.

#### *Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2025*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 82,708,067 lekë, ku totali i tyre shkon në vlerë 82,708,067 lekë, e cila nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Veprimet janë në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja “ë”; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Prrenjas, të marrë masat për të bërë verifikimet dhe sistemimet përkatëse në kontabilitet të llogarisë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale”, 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” me kundër partitë përkatëse të këtyre llogarive.

#### *Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2025*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se, çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 1,450,630,388 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 17,449,305,980 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 22,108,530 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 80,356,394 lekë, amortizimin shtesë në vlerën 73,025,701 lekë, sistemimet e bëra si rezultat i konstatimeve për kontabilizimet e dubluara në periudha të mëparshme në vlerën 132,618,378 lekë dhe amortizimin e pakësimit në vlerën 4,280,413 lekë për vitin ushtrimor 2024 sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 është nënvlerësuar në vlerën 127,145,303 lekë. Veprimet janë në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja “ë”; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, të marrë masat për të bërë verifikimet dhe sistemimet përkatëse në kontabilitet të llogarisë 101“Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” dhe kundër partisë përkatëse të kësaj llogarie.

#### *Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2025*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se, llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 190,338,038 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 237,089,210 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumës së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 267,205,176 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 38,675,760 lekë. Veprimet janë në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja “ë”; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, të marrë masat për të bërë verifikimet dhe sistemimet përkatëse në kontabilitet të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe kundër partisë përkatëse të kësaj llogarie.

#### *Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2025*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.189/19, datë 25.06.2024 rezultoi se:

- Bashkia Prrenjas me shkresën nr.1796/2 prot., datë 15.07.2024 ka dërguar në KLSH planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Bashkia Prrenjas me shkresën nr.1796/4 prot., datë 06.12.2025 ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit prej 6-muajsh, sipas përcaktimit të bërë

në pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Janë lënë 21 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht nga të cilat, 8 janë zbatuar, 4 zbatuar pjesërisht, 2 në proces dhe 3 nuk janë zbatuar;

-Për 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të tyre, rezulton e pazbatuar;

-Për 1 masë për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia në vlerën 5,561 mijë lekë, rezulton e pazbatuar;

-Për 6 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, në vlerën 116,511 mijë lekë, rezulton se janë zbatuar pjesërisht 3 masa për vlerën 13,629 mijë lekë, si dhe nuk janë zbatuar 3 rekomandime për vlerën 22,903 mijë lekë. Nisur nga sa më sipër, veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 15, “Të drejtat e KLSH” të ligjit Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 71-85, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1.Rekomandimi:**Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si edhe konstatimit të përsëritjes së problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara, për përmirësimin e gjendjes, si dhe me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar si më poshtë:

**Menjëherë**

**Masat organizative të lëna në auditimet e mëparshme.**

**1.1.Rekomandimi:** Nga Titullari i Bashkisë Përrenjas, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**9.1. Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Përrenjas), të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

**10.1.Rekomandim:** Bashkia Përrenjas të marrë masa që për procedura të ndara me faza, me objekt hartimin e planeve të mbarështimit, vlerësimi i fazës së parë kualifikuese të jetë i tillë që të mundësojë konkurrimin e shumë operatorëve ekonomikë në fazën e dytë, duke i konsideruar urdhrat e ministrit për miratimin e planeve të mbarështimit si vërtetime që provojnë kryerjen e shërbimeve të ngjashme.

**11.1.Rekomandimi:** Bashkia Përrenjas të marrë masa që në punimet për rikonstrukcione të rrugëve të përfshijë zërat për asfaltim dhe punime të tjera, me qëllim realizimin e investimeve në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme si dhe të argumentojë përmes një relacioni teknik arsyet e ndryshimeve të zërave të punimeve për procedura me objekt të ngjashëm prokurimi.

**14.1.Rekomandimi:** Bashkia Përrenjas të marrë masa për ngritjen e një strukture të posaçme për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në funksion të përditësimit të inventarit dhe regjistrimit e pasurive të paluajtshme, përmes verifikimit juridik dhe faktik (evidentim në terren) të gjendjes së pronave. Në veçanti, të përcaktojë si prioritet regjistrimit e pasurive të paluajtshme të shërbimeve arsimore, si shkolla, kopshte dhe çerdhe.

**15.1.Rekomandimi:** Bashkia Përrenjas të marrë masa që të parashikojë fonde për miratimin e planeve të mbarështimit për ekonomitë pyjore, regjistrimit e sipërfaqeve pyjore si dhe për plotësimin e numrit të inspektorëve në pyje në raport me sipërfaqet në hektarë që i janë transferuar.

**16.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Përrenjas dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe të bëjë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

**16.2.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

**17.1. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Përrenjas, të vijoje procedurën për nxjerrjen e Vendimit për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm", që janë me procesverbal konstatimi për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi dhe të nxjerrë "Urdhër Ekzekutimi" për prishjen e objekteve të kundërligjshëm për subjekte që janë me Vendim për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm".

**17.2. Rekomandimi:** Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Përrenjas, të marrë masa si vijon:  
-Mbajtjen e aktkontrolleve për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

-Moslejimin e zhvillimit të ndërtimit në kushtet e mungesës së lejes së zhvillimit dhe të ndërtimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

-Në çdo rast që konstatohet shmangie nga projekti i miratuar, përveç ndëshkimit me masë administrative, heqjen e licencës profesionale për personat përgjegjës, sipas parashikimeve ligjore, me qëllim forcimin e masave për kontrollin e territorit dhe mbrojtjen e tij nga ndërhyrjet abuzive.

-Rritjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Politikave Urbane, për shkëmbimin e informacionit midis tyre. Realizimin e kontrolleve periodike mbi objektet në zhvillim, të pajisur me leje ndërtimi, për të verifikuar nëse zbatimi i punimeve kryhet sipas projektit të miratuar.

-Përgatitjen e planeve vjetore dhe mujore të punës dhe informacionin periodik tre mujor ndaj Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) mbi aktivitetin e saj, procedurat e mbajtura gjatë kësaj kohe dhe vendimet e marra.

**1.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Përrenjas dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për arkëtimin e detyrimeve të palikuiduara nga debitorët progresivë për vitin 2022, nga mospagesa e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara në paketën fiskale nga subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi si dhe nga subjektet familjare në vlerën totale 63,391,576 lekë.

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Urbanistikës të përcjellë listën me subjektet debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë si dhe në vijim Bashkia Përrenjas të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha

procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 2,526,900 lekë.

**6.1 Rekomandimi:** Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës, personit të ngarkuar për llogaritjen e TNI për objektet e reja që kanë tipologjinë e mësipërme, taksa të përlllogaritet bazuar në çmimin e shitjes.

**6.2 Rekomandimi:** Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e Taksave Tarifave Vendore të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej 10,047,964 lekë ndaj 2 subjekteve për llogaritje të gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga të cilat 4,170,770 lekë për subjektin L. B. dhe E. B. si dhe 5,877,194 lekë për subjektin M-P.

**Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të tyre.**

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Përrenjas të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

**Masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia.**

**1.1.Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Përrenjas, Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave, dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve kontraktuale në vlerën **2,729,835 lekë**, si dhe kamatëvonesa deri më 31.12.2023 në vlerën **2,831,729 lekë**.

**Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash.**

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **2,037,791 lekë**.

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave, në bashkëpunim Njësitë Administrative të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, duke verifikuar në terren si dhe marrjen zyrtare e të dhënave nga institucionet përkatëse. Pas identifikimit dhe evidentimit me të gjithë treguesit të parcelave të tokës që disponon çdo fermer, të rishikohet planifikimi i të ardhurave për këtë taksë, të ndiqet arkëtimi i saj nëpërmjet njoftim-vlerësimeve për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermerë dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative e ligjore në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit. Gjithashtu të ndiqen të gjitha rrugët ligjore deri në arkëtimin e vlerës 16,865,439 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Përrenjas.

**3.1.Rekomandimi:** IMTV dhe Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave në Bashkisë Përrenjas të ndjekin të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **4,000,000 lekë**.

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave Bashkia Përrenjas në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Përrenjas, si, Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit Territorit, Drejtorinë

Juridike, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Financës, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **87,518,388** lekë kjo për subjekte/abonent familjare, për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve bashkia Përrenjas, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **1,600,000** lekë nga 2 subjektet, respektivisht;

-Vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “L.” SHPK.

-Vlera 600,000 lekë nga subjekti “K.” SHPK.

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Përrenjas, të marrë të gjitha masat duke zbatuar të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për nxjerrjen dhe kontabilizimin e detyrimeve për tarifën e “*Mjedisit*” dhe tarifën e “*Pastrimit*” për 25 subjektet në vlerën **4,490,000 lekë**, respektivisht:

-Vlera 700,000 lekë për 2 subjekte HEC.

-Vlera 2,250,000 lekë për 9 subjekte me lloj aktiviteti si, karrierë guri, inerte etj.

-Vlera 1,540,000 për 14 subjekte me veprimtari Hec, Gurore, Minierat dhe Nyje betoni etj.

**6.2.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Përrenjas të ushtrojë kontrole pranë aktiviteteve të subjekteve të cituar më sipër, me qëllim identifikimin nëse, ushtrohet ose jo veprimtaria prej tyre.

**Menjëherë**

### **C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRIUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit 2024 në territorin e Bashkisë Përrenjas kanë ushtruar aktivitet 5 (pesë) subjekte me objekt veprimtarie tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse, apo pa likuiduar të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore, gjë e cila ka sjell të ardhura të munguara për bashkinë Përrenjas në vlerën prej 4,400,000 lekë. Në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “*Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre*”, të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2 si dhe VKM nr. 344, datë 19.04.2017 pika 2/9. Këto subjekte duhej të pajiseshin me autorizimin përkatës vetëm pas kryerjes së plotë të pagesës. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t’i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë/autorizim, për aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor, si dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të krijuara nga subjektet me tregtim të lëndëve djegëse.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se, në 31.12.2024 bizneset kanë krijuar një borxh progresiv prej 24,050,662 lekë. Drejtoria e të Ardhurave nuk ka aplikuar penalitetete në përputhje me përcaktimet

e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 114 (24,050,662x21.9%=5,267,094), për arkëtimin e vlerës së detyrimit prej 5,267,094 lekë, vlerë kjo që duhet të kontabilizohet në vijim. Në përfundim, bizneset kanë krijuar një borxh prej **29,317,757 lekë**, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për Bashkinë Prrenjas. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)..

**2.1 Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për të nxjerrë njoftimet e vlerësimeve për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura të subjekteve, duke përlogaritur edhe penalitetet përkatëse, si dhe të kryejë kontabilizimin e tyre, në vlerën prej 29,317,757 lekë.

*Deri në fund të vitit 2025*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2023 është në vlerën 91,432,408 lekë, vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2024 është 63,907,340 pakësimet gjatë vitit 2024 janë 57,543,302 lekë dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive në fund të vitit 2024 është në vlerën **97,796,446 lekë** (nga të cilat vlera 24,050,662 i përket biznesit). Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore, pas dërgimit të njoftimeve për pagesat e taksave vendore, nuk duhej të ndalej, por duhet të vijojnë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Prrenjas, të marrin masa konkrete duke përdorur të gjithë instrumentet ligjorë të parashikuar për mbledhjen me forcë të detyrimeve të papaguara me qëllim uljen e borxhit nga taksat dhe tarifat vendore.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi lidhur me debitorët për taksën e tokës bujqësore, për vitin 2024, për 4 njësit administrative rezultoi të jetë në vlerën 2,773,869 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Prrenjas. Gjithashtu, në regjistrin e debitorëve familjarë me datë 31.12.2024 konstatohen 42 punonjës/familjarë të punonjësve të Bashkisë Prrenjas, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet për taksën e tokës. Vlera debitorë e krijuar nga 42 punonjës të Bashkisë Prrenjas është në vlerën 499,923 lekë. Rrjedhimisht, mundësia e arkëtimit të tyre nga titullari i Bashkisë Prrenjas dhe Drejtoria e të Ardhurave është e mundur. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Kryetari Bashkisë Prrenjas dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore 2,773,869 lekë, përfshi këtu edhe 42 punonjës të Bashkisë Prrenjas debitorë.

*Menjëherë*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi masat e marra për faturimin dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga objektet e legalizuara u konstatua se nga STTV, nuk janë ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj.) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale. Vlera debitorë progresive është 2,046,409 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Prrenjas. Veprime këto në kundërshtim me pikën 2 të nenit 89 të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe të pikës 1 të nenit 22/5 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e

taksave vendore” të ndryshuar.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 2,046,409 lekë

*Menjëherë*

**6. Gjetje nga auditimi:** Sipas VKB-së nr.4, datë 27.12.2023 Për “Miratimin e Paketës Fiskale Vendore viti 2024”, si agjent tatimor për vjeljen e taksës vjetore të mjeteve të transportit rrugor, është përcaktuar “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor (DRSHPTRR)”, e cila derdh me anë të faturës për arkëtim përqindjen e përcaktuar të totalit mujor të të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit. Nga rakordimet mujore të bëra me këtë drejtori, konkludohet se realizimi i të ardhurave nga taksa e mjeteve të përdorura për vitin 2024 është 11,861,483 lekë, ose 11,7% e të ardhurave totale për Bashkinë Prrenjas. Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2024 agjenti tatimor DRSHPTRR rezulton debitor në vlerën prej **3,072,588 lekë**, vlerë e cila nuk është kontabilizuar dhe që përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Prrenjas.

Për këtë agjent, Bashkia Prrenjas duhet të llogarisë gjobë në masën 0.06% për çdo ditë vonese, por jo për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike, në bazë të ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 117, pika a. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1.Rekomandimi:** Bashkia Prrenjas, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës vjetore të mjeteve të transportit rrugor në vlerën 3,072,588 lekë dhe penalitetet, si dhe të kryejë kontabilizimin e saj.

*Deri në fund të vitit 2025*

## **D. MASA DISIPLINORE**

**D1.** Për punonjësit në marrëdhënie pune Mbështetur në Nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Prrenjas, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për punonjësit e mëposhtëm:

**9. Znj. M.V**, në cilësinë e Drejtorit në Drejtorinë e të Ardhurave për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93, ku masat e ndërmarra për uljen e borxhit janë të pjesshme dhe jo mjaft efektive.

-Për shkeljet e konstatuara në ushtrimin e aktivitetit gjatë vitit 2024 të 5 subjekteve me tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse, apo pa likuiduar të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore.

**10. Znj. O.M,** në cilësinë e Specialiste Biznesi, për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93, ku masat e ndërmarra për uljen e borxhit janë të pjesshme dhe jo mjaft efektive.

-Për shkeljet e konstatuara në ushtrimin e aktivitetit gjatë vitit 2024 të 5 subjekteve me tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse, apo pa likuiduar të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore.

**11. Z. I.G,** në cilësinë e përgjegjës të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93, ku masat e ndërmarra për uljen e borxhit janë të pjesshme dhe jo mjaft efektive.

-Për shkeljet e konstatuara në ushtrimin e aktivitetit gjatë vitit 2024 të 5 subjekteve me tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse, apo pa likuiduar të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore

**12. Znj. B.K,** me detyrë Përgjegjës Sektori i Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Aktiveve, për mangësitë e trajtuara në pikën 2.3 të Raportit Përfundimtar të auditimit “Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar”.

## **E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit pjesë e shërbimit civil, për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Prrenjas, Sektori i Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**